



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË TRETË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 27.03.2018 (e Martë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, Kryetari z. Sokol Haliti nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu; këshilltarët e Kuvendit: Vjollca Kadolli-Halili, Basri Sylejmani, Rufadije Halimi-Rexhepi, Valbona Haziri, Afrim Ramushi, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emimi, Remzi Salihu, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Vehbi Rama, Valentina Hasani, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesi i Zyrës për Integritet Evropian, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e tretë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes kryetarin e Komunës së Vitisë, z.Sokol Halitin, nënkryetarin e Komunës, z.Hasan Aliu, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, KFOR-in amerikan që është prezent, mediat e shkruara dhe të gjithë të tjerët që janë prezent! Meqenëse java e kaluar ka qenë një javë e stërmëshur me aktivitete kulturore dhe sportive për nder të rënies heroike të komandantit Nijazi Azemi “Komandat Mjegrës”, unë ju falënderoj të gjithë këshilltarëve komunal për prezencën tuaj në aktivitetet një javore. Gjithashtu më lejoni ta falënderoj edhe DKRS-në për një aktivitet të mirë dhe të qëlluar. Dëshiroj të ju informoj, se MAPL-ja, përkatësisht Zyra Ligjore e tyre na ka konfirmuar pjesën dërmuese, të akteve të cilat janë në harmoni me ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës. Kemi edhe 2 vendime, nuk na kanë konfirmuar akoma, por ato janë vendime të cilat po i dërgojnë në ministritë e linjave. Unë e kam pas dje një takim me ta, është shqetësuese për të gjithë kryesuesit e kuvendeve një qasje e tillë se ata po i vonojnë.

Për seancën e tretë kemi paraparë këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Kuvendit Komunal të Vitisë.
2. Informatë e punës së Kryetarit të Komunës për periudhën Janar-Dhjetor 2017.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim plotësimit të rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoha me Nr. 01-110/05-58, e datës: 02.02.2018.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2017 në vitin 2018.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin e veprimit për transparencës në Komunën e Vitisë për vitin 2018.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Komitetit për Barazi Gjinore.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e asamblistëve të cilët do ta përfaqësojnë Komunën e Vitisë në Asociacionin e Komunave të Kosovës.
8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit nr.01-410/03-52, të datës 01.02.2018, të Komitetit për Politik dhe Financa.
9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të vendimit nr.01-410/03-57, të datës 02.02.2018, të Komitetit për Komunitete.
10. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Plani Zhvillimor Komunal.

A ka dikush rreth rendit të ditës ju lutem .

znj. Mirlinda Sadiku: Nuk e di a është gabim teknik apo kemi harruar ta shtojmë edhe pikën e fundit, e cila ka të bëjë me pyetje të ndryshme që ju drejtohen ekzekutivit.

Kryesuesi Naim Pira: Nuk e kam harruar këtë, por na nuk e kemi shti si pikë të rendit të ditës, se ajo është pikë jashtë rendit të ditës, dhe natyrisht na nuk kemi qe e shënojmë këtë, se na në vazhdimësi kemi me diskutuar nëse ka pyetje dhe propozime. Atëherë unë e hedh në votim: Kush është që të miratohet ky rend i ditës me këto pika? Konstatohet se me vota unanime u miratua rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Kuvendit Komunal të Vitisë.**

A ka dikush rreth pikës së parë? Pasi nuk ka e hedhin në votim. Konstatohet se me vota unanime kalon pika e parë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

2. **Informatë e punës së Kryetarit të Komunës për periudhën Janar-Dhjetor 2017**

Është një informatë që kryetari ka pasur kujdes që për çdo vit të ju drejtohet anëtareve të Kuvendit Komunal për punën e cila është krye në periudhën e viteve të kaluara dhe kësaj here. Atëherë unë po ja jap fjalën kryetarit që të na informoj në pika të shkurtra.

z.Sokol Haliti. I nderuar z.Kryesues i Kuvendit!

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit!

Të nderuar Drejtorë, Përfaqësues të Institucioneve të Komunës, Media dhe Shoqëri Civile!

Në bazë të kompetencave dhe autorizimeve ligjore që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, sot para juve paraqes Raportin e Punës për periudhën Janar - Dhjetor 2017.

Në këtë raport janë dhënë detajet e nevojshme të angazhimit tonë për periudhën paraprahe njëvjeçare në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës sonë. Fjalën time hyrëse e kam përpiluar në formë të një përmbledhje ekzekutive të Raportit, gjersa për detaje dhe punë të specifike sipas drejtorive dhe zyrave, ju lus t'i referoheni raportit në plotësinë e tij.

Ne sapo kemi përfunduar mandatin tonë katër vjeçare të qeverisjes sonë të mirë fill të dhe efektive, që realisht Vitinë e ka kthyer tanimë në një komunë meritore për qytetarët e saj. Mirëpo, sukseset tona të deritanishme nuk kanë qenë pa sfida dhe pa barriera, siç edhe mund të paramendohet. Mirëpo, besoj se sukcesi ynë më i madhi përbashkët ka qenë tejkalimi i këtyre sfidave në favor të qytetarëve të Vitisë. Me këtë moto, ne e mbyllëm vitin 2017 si një vit të suksesshëm për komunën tonë, për kundër të gjitha sfidave që i patëm para vete.

Me bashkëpunim të ndërsjellët, me mirëkuptim dhe punë të palodhur ne kemi arrite që në vitin 2017 të realizojmë me sukses një sërë projektesh që janë jetike për të ardhmen e Komunës së Vitisë. Raporti që po e prezantojmë sot, përfshinë detaje nga këto të arritura dhe sukseste të qeverisjes sonë me prioritetet si në vijim, Rritja e efikasitetit në Administratë, Zhvillimi i bujqësisë, Shëndetësia, arsimi, kultura dhe sporti, Infrastruktura lokale, Shërbimet publike, Zhvillimi ekonomik, Përkujdesja për shtresat e varfëria dhe grupet e marginalizuara, Bashkëpunimi me shoqërinë civile, donatorët dhe investitorët, Mbrojtja e ambientit dhe kualiteti i jetës.

Administrata:Drejtoria për Administratë ka ofruar shërbime më kualitative për qytetarë, është zvogëluar koha e pritjes për shërbime, dhe janë lëshuar 51320 dokumente, Numri i qytetarëve të regjistruar në sistemin e gjendjes civile është 48425.

Bujqësia:Janë bërë kontrollime të tregut të gjelbër të kafshëve, të materialit fidanor, barnatoreve bujqësore, fermave blegtorale, etj. Është bërë rregullimi i rrugëve bujqësore (projekt dy vjeçar), i cili projekt vazhdon edhe në vitin 2018, Janë pranuar 1762 aplikacione për subvencione. Për fermerët e Komunës së Vitisë, janë shpërndarë foli najloni, sistemit të ujitjes pikë pike, fidanë të shalqirit, fidanë të mjedrës, fidanë të dredhëzës, inkubatorë, koshere për bletë, makina spërkatëse, si dhe makina mjelëse për lopë qumështore. Totali i investimeve nga Komuna në fushën e bujqësisë (pa participimin e donatorëve) është 79.125€.

Arsimi: Është organizuar me sukses Testi i Maturës, ku kalueshmëria e këtij testi është 77.85%. Kalueshmëria për Testin e Arritshmërisë për klasat e IX-ta është 73.41%. Janë mbajtur debate për tema të ndryshme rreth dukurive negative të nxënësve në shkolla. Është bërë renovimi i 8 shkollave. Janë rregulluar rrethojat e oborreve në 4 shkolla, si dhe projekte të ndryshme në infrastrukturën shkollore.

Financa, Ekonomi dhe Zhvillim: Është bërë përgatitja e të gjitha projekteve kapitale. Shpenzimi i buxhetit është realizuar afër 99.5%. Inkasimi i tatimit në pronë është realizuar afër 69.22%. Trajnimi i shumë bizneseve për menaxhim biznesi. Mbështetja e bizneseve për aplikim te donatorët. Mbështetja e investitorëve për investime në komunë. Tryeza me diasporën për investime në komunë.

Kulturë, Rini dhe Sport: Është bërë subvencionimi i 15 OJQ-ve në vlerë prej 76.460€. Janë ndarë subvencione për Kulturë në vlerë prej 15.900€, ndërsa për sport 51.930€. Për aktivitetet rinore, janë ndarë subvencione në vlerë prej 8.630€. Është organizuar manifestimi tradicional “Flakadani i Karadaku”. Janë mbajtur aktivitete të shumta me rastin e ditëve të Diasporës. Janë ndërtuar fusha sportive të futbollit dhe volejbollit. Ka filluar ndërtimi i Palestrës Sportive në Viti, si dhe projekte tjera në zhvillimin e sportit dhe kulturës.

Urbanizëm dhe Mbrojtje e Ambientit: Është bërë shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimore. Shqyrtimi i kërkesave për pëlqim urbanistik. Shqyrtimi i kërkesave për kushte të ndërtimit. Pastrimi i ambientit me moton “Ta pastrojmë Vitinë”. Shënimi i datave me rëndësi për ambientin. Vizita të shumta në teren. Aktivitete të tjera kontinuele.

Shërbime Publik edhe Emergjencë: Është realizuar i projektit “ Punësimi i përkohshëm në dobitë komunitetit (në bashkëpunim me Organizatën Kosova Luksemburg). Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit veror dhe dimëror. Eliminimi i deponive ilegale në për fshatra. Mirëmbajtja e kanalizimeve dhe ujësjellësve. Pastrimi i hapësirave publike. Mirëmbajtja e ndriçimit publik. Intervenime të shërbimit të zjarrfikësve.

Shëndetësia: Është bërë promovimi i shëndetit përmes ligjëratave për sëmundje të ndryshme. Ofrimi i shërbimeve për qytetarë në mjekësinë primare dhe specialistike, ku numri i shërbimeve të ofruara për vitin 2017 është 445000. Janë mbajtur trajnime të ndryshme për stafin mjekësor dhe atë infermieri. Asfaltimi i parkingut të QKMF-së pas objektit të Emergjencës. Renovimi i 4 AMF-ve. Ndërtimi i garazheve për automjetet e QKMF-së. Suvatimi dhe izolimi i jashtëm i objektit të QKMF-së (vazhdon ende). Vazhdimi i AMF-së në Skifteraj (projekt dyvjeçar).

Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi: Është bërë shqyrtimi brenda afatit ligjor i kërkesave të adresuara nga qytetarët. Avancimi dhe modernizimi i shërbimeve kadastrale. Tërheqja e investimeve dhe garantëve nga donatorët huaj. Evidentimi i të gjitha pronave komunale. Realizimi i të hyrave. Aktivitete tjera kontinuele në fushëveprimtarinë e drejtorisë.

Inspeksioni: Është bërë inspektimi i bizneseve që janë aktive në Komunën e Vitisë. Organizimi i aktiviteteve të transportit me operatorët e transportit publik dhe të mallrave në Komunën e Vitisë. Kontrollimi i infrastrukturës rrugore, furnizimi dhe vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale të komunikacionit. Inspektimi i ushqimeve me prejardhje shtazore. Inspektimi i ujërave të pijshëm. Inspektimi i ndërtimeve në Komunën e Vitisë. Aktivitete tjera kontinuele. Për pyetje apo për sugjerime do të jam në dispozicion të ju ndihmoj.

Kryesuesi Naim Pira: Faleminderit kryetar. Hapim debat rrethë kësaj pike të rendit të ditës. Fillimisht ja kisha dhanë fjalën kryetarëve të grupeve parlamentare e mandej të tjerëve.

z.Vjollca Kadalolli: I nderuar Kryetar i Komunës, Kryesues i Kuvendit Komunal, Drejtor, Këshilltar, Shoqëritë Civile, Përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, Mediave dhe ju tjerë të pranishëm! Sot para nesh kemi informatën e punës së kryetarit, qeverisë komunale për periudhën Janar-Dhjetor 2017. Informata në fjalë në aspektin teknik është mirë e përgatitur, është voluminoze e shumë përmbajtjesore për punët dhe aktivitetet e kryera gjatë një viti. Vet ofrimi i kësaj informate

tregon përkushtimin, përgjegjësinë dhe respektimin e Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, njëherë edhe punën transparente të organeve komunale, gjegjësisht ekzekutivit të Komunës. Në vitin 2017 ne jemi ballafaquar me dy parë zgjedhje, si në nivel qendror ashtu edhe në atë komunal, e kjo informatë në material tregon se ishte një vit i suksesshëm për Komunën tonë. Këtë e argumentoj nga ofrimi i shërbimeve të mira për qytetaret, subvencionim i të gjitha kategorive të fermerëve, rritja e cilësisë në Arsim, ku kalueshmëria e testit të maturës ishte 77.85%, ndërsa testi i arritshmerisë 73.41%, shpenzimi i buxhetit në 99.5%, subvencionim i OJQ-ve, klubeve sportive, organizim i shkëlqyeshëm i festave komunale dhe kombëtare me rendësi të veçantë ka qenë “Flakadani i Karadakut”, rritja e hapësirave të hapura publike, trotuareve, ndriçimit publik, rritja e cilësisë. Për të gjitha këto që ceka me lart, në mënyrë direkte apo indirekte janë përfitues vet qytetaret e Komunës së Vitisë si dhe të gjitha këto shërbime kanë ndikuar në rritjen e kualitetit. Kryetar, të përgëzoj për punën që keni bërë në vitin 2017, ndërsa për vitin 2018 kërkoj të ketë një rritje në përmirësim të kushteve për shërbyesit civil, konkretisht të ushtrohet ndikim sa më i madh i juaji, që sa më shpejt të kalohet në objektin e Komunës së re, shtim i aktivitetit të drejtoresve nëpër shkollë, që të shtohet disiplina dhe të arrihen rezultate edhe me të mira në të ardhmen, përmirësim me i madh i situatës gjinore në Komunë sidomos në shërbimin civil që në kushte të barabarta ti jepet përparësi gjinisë femërore. Jam shumë e sigurt, që me hapa të vegjël, por të rëndësishëm drejt shërbimeve më të mira komunale, investimeve dhe subvencionimeve bëjnë ndryshim të madh në jetën e qytetareve tanë. Nuk kam dyshim se me vendimet tuaja të guximshme mundet të sillni ndryshime afatgjate. Këtë mund ta arrijmë së bashku, e me siguri të plotë e them, se Vitia ka nevojë vërtetë për përkushtimin tuaj dhe të Kuvendit Komunal.

znj.Mirlinda Sadiku: Unë do të jem ma konkrete, për mi lavdu i lavdoj boll doktoresha. S’di a u ba gabim teknik, po mungon faqja 16 dhe 17 tek ky raport. Do të kisha pas dëshirë, që drejtoret ti marrin pyetjet e të na japin përgjigjet nëse i kanë informatat, se kryetari mundet me dhanë përgjigje, por edhe gjithsecili që është përgjegjës për dikasterin e vet, përgjigjet mujn me qenë ma të sakta dhe ma precize. Te Drejtoria e Financave, tatimi në pronë, përderisa në vitin 2016 inkasimi, gjithnjë po flas sipas raportit që na është dhënë është realizu diku rreth 96%, kurse realizimi i planit në vitin 2017 është 69.22%, pra, ka një rënie. Na të gjithë e dimë, që në vitin e kalim ka ekzistuar ende Ligji në fuqi për Faljen e Borxhit, por pse nuk mujt komuna ta mbaj trendin e rritjes të inkasimit në pronë, kur e dimë se inkasimi në pronë direkt shkon tek investimet që i prek dora e qytetarit. Në raportin e drejtorit thuhet, se janë lidhur vetëm 25 marrëveshje me tatim pagues, që është shumë pak. Edhe në vitin e kalim edhe në këtë vit fiskal, flas me kompetencë të plotë, pasi që edhe unë jam tatimpagues. Faktuarat vazhdojnë trendin që të shpërndahen nëpër shkollë, pa arritur deri te adresa e caktuar, duke e humbur edhe afatin ligjor që njerëzit kanë të drejtë ligjore që të ankohen. Tek vendimet gjyqësore për investime publike, shumen 43.898 euro edhe Zyra e Financave ka pagu 3.819 euro, pse ka ndodhur kjo, apo është ndonjë operator ekonomik e ka fitu rastin, e u dashtë me vendim gjyqësor ti jepen paratë. Drejtoria e Inspeksionit, gjithë jemi të vetëdijshëm për kontrollet e inspeksionit, që është shumë e rëndësishme të bëhen qoftë për respektimin e duhanit, edhe pse Drejtoria e Inspeksionit e ka një domen shumë të gjanë, megjithatë unë isha fokusi, se i keni bërë 32 kontrolle mbi kualitetin dhe cilësinë e produkteve, përafërsisht

për 12 muaj 3 kontrole, e kjo është pak, duke e ditur që bizneset mund të kenë edhe jashtë afatit. Shpeshherë e kam cek edhe në këtë foltore, kam kërku, që sidomos dyqanet të cilat janë afër shkollave të kenë parasysh e kujdes. Drejtor, si është gjendja e ujit nëpër shkolla. Ju kujtohet në bazë të një raporti, përbërja e ujit ka dal shumë e dyshimtë nëpër shkolla, e do te kisha pas qejf ta kem një përgjigje nga ju. Konfiskimi dhe largimi i mallit, keni bërë vetëm në mënyrë perspektive, keni përshkru sa është ajo sasi, vendosja e shenjave vertikale dhe horizontale. Drejtor, tek shkolla e mesme profesionale është vendos një polic i shtirë, mirëpo ai polic i shtirë brenda një muaj dite është prish, nuk i ka rezistitu kohës. Po ashtu pjesa që ka qenë e caktuar për biçikletat, në bazë të planit të mobilitetit ajo nuk ekziston. Ma kjo ka ndodh në vitin 2017. Po ashtu drejtor keni cek, i referohem faqes 35, gjendja e ndërtimit është në kontroll, ku në raportin tuaj e ceki, ka mjaft shkelje të procedurave përkatëse për ndërtim. Ky informacion na ka ardh prej zyrës tuaj, është shqetësuese pse ka shkelje të procedurave. Ju i keni mekanizmat në bazë të cilave mund të funksiononi. Po ashtu drejtor ndalem te konstatimi juaj, gjendja mjedisore në territorin e komunës nuk është e kënaqshme, sidomos mbeturinat. Te ujërat e zeza mungojnë gropat septike. Është shqetësuese edhe informata e juaj, menaxhimi i mbeturinave medicinale nuk është sipas standardeve, pse me ndodh kjo, se ne e kem pas aprovu një rregullore pikërisht për menaxhimin e mbeturinave. Nëse këto i ekspozohen publikut, sidomos fëmijëve, është një lajm shumë shqetësues, si dhe pse shumë fshatra e kanë shpreh gatishmërinë për me hi në sistem të menaxhimit të mbeturinave, por një mundësi e tillë nuk ju ka ofru përmes kompanisë, d.m.th. nuk janë ofru shërbime. Pse po ndodh kjo, cila është arsyeja, a është mungesë e koordinimit të punëve mes kompanisë “Eko higjiena” apo çfarë? Kam pyetje për drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Në seancën e kaluar nënkryetari e konfirmoj, z.Hasan Alia, në bazë të pyetjes që unë e parashtrova, se numri i punëtorëve që ka qenë me KARITAS-in ka qenë numër i madh e nuk është specifiku numri e dikujt, i janë dhëne dy paga e dikujt vetëm nga një pagë, pse ka ndodhe kjo. E di që është projekt i përbashkët me ministrinë atje, po ku ka qalu ky problem, edhe pse këta njerëz nuk janë pagu për punën që e kanë bërë. Po ashtu kam pyetje që ka të bëjë me arsimin. Është cekur në raport, që janë ba kontrolla shëndetësore sistematike, a keni raport të saktë se sa fëmijë i ke kontrollu pak ma të detajume, se ne e dimë që nxënësit që janë prej klasës së parë deri në klasën e gjashtë për shkak rënsisë, peshës së çantave, ata po shkaktojnë deformitete. Janë 10 drejtori, nga një minutë 10 minuta. E keni rregulloren, po është në pyetje 10 drejtori, e unë nuk mundem me fol shumë shpejt. Kjo është informatë që na duhet me diskutu, pse me mu cungu e drejta. Unë nuk mundem për një minutë me parashtru pyetje. Drejtori i Arsimit, ambulanta në Skifteraj ka qenë projekt dyvjeçar, është dashur të përfundoj në fund të vitit 2017 në bazë asaj qysh e keni ma herët me foto kjo nuk është funksionalizu. Pse nuk ka sigurim te hyrjet në QKMF, edhe në Viti edhe në Pozheran. Kemi raste të ndryshme që vinë e ata mund të jenë edhe agresiv, e paraqesin rrezik për punëtorët shëndetësor. Arsimi, e kemi strategjinë e sigurimit të cilësisë 2016-2020, janë nda diku rreth 8.2 milion euro, asnjëherë nuk u precizu te drejtoria juaj, që është sfidë mu implementu. Nxënësit po mësojnë me libra të vjetër, e di që është kompetencë e ministrisë, po pse ka ndodhë kjo. Është shkurtim i buxhetit, i qeverisjes ku ka qeverise LDK-ja apo çfarë. Pse disa shkolla ende nuk kanë drejtor. Skandali me matrapazin i ka tejkalu gjithë kufijtë. Shpresoj dhe besoj që nuk do të ndodhë në të ardhëm, e kam cek edhe

këtu, që ju ka marr edhe pare fëmijëve. Po ashtu sfidë për juve duhet me kanë shkolla e vjetër, që nuk është funksionalizu, janë gjashte kabinete me saktë e di unë, po ashtu asnjëherë nuk është mëndu, që gjimnazit ti mbështetet një anekse, palestër te vogël sportive, që ata fëmijë me kry orën e edukatës fizike. Drejtorja e Urbanizmit, faqe 60, e keni cek se të gjitha projektet të cilat po realizohen nga Komuna, si ato infrastrukturore dhe ato ndërtimore, nuk po pajisen me leje mjedisore komunale. Pse po ndodhë kjo, është shqetësuese. Kam pyetje për Drejtorinë Komunale për Rini dhe Sport, faqe 77, kur është bërë raporti tek vendimet, aty ekzistojnë dy pikëpyetje, nuk është dhanë një sqarim lidhje me 8.000 euro edhe pse Drejtoria Komunale për Rini dhe Sport ka pagu 8.66 euro vendime gjyqësore. Auditori i brendshëm i ka dhënë 25 rekomandime, vetëm 5 janë tu zbatu, pse po ndodhe kjo?

z.Bekim Azizi: Përshëndetje për te gjithë te pranishmit, Kryetar, Nënkyetar, Drejtor, Anëtarë të Kuvendit, KFOR-it dhe ju pjesëmarrës të tjerë që jeni të pranishëm. Për dallim nga Mirlinda, që u murr me drejtor, ne jemi tu diskutua një pikë të kryetarit, por s' di hala a janë drejtor, sepse prej marrjes së mandatit si ka shpalle drejtor. E dimë se njeri ka dhanë dorëheqje, e sot e ka seancën e fundit që do të jete këtu, e pse ka dhanë dorëheqje ai e di edhe ne e dimë, por do të kyçem kryesisht te punët që i shohim na, tu llogaritë që viti i kalum është shfrytëzua mjaft mirë si vit për fushatë dhe këtë shfrytëzim e kanë arrit. Unë do të lidhem në shumë gjana që i diskutoj edhe kryetari edhe ato vërejtjet tona. Shqetësimi kryesor është cilësia e punëve që kryhen, sepse investimet që bahen kryesisht te punët tregon një cilësi shumë të dobët të punëve, që kryhen brenda ditës e brenda natës, ato që nguten për dy tri ditë e mas ni jave prishen asfaltet, dhe kjo tregon pamjen që prishen asfaltet, vetëm dy senti metra e gjysmë asfalt, që ku i keni pamjet kryetar, këto janë, nuk po e akuzoj drejtpërdrejtë kryetarin, se kryetari s' del me mat trashësinë e asfaltit, po ka gjithë ato faktor që vinë deri te pranimi i tyre. Mosrespektimi i planit urbanistik, mos marrja e lejeve dhe nga drejtoritë e tua për mi kry punët. Vet jeni kanë ata të paret që nuk i keni respektu planet urbanistike. Dalmi te vërshimi që i murr këto pjesët e lumit, tregon çfarë cilësie e punimi ka, sepse këto punime tregojnë cilësinë që e kanë kry këto asfalte. Herave tjera përherë i kena akuzu që i kane shtru në dhjetor, në temperatura të ulëta, e kësaj radhe krejt janë shtruar deri me 22 Tetor, krejt nëpër lagje duke bërë pazar për këmbim te votës, që është një prej shqetësimeve kryesore e jo t' mira. Shohim dokumentin që e nënshkruan kryetari, e prezanton, lidhet prej Lutfi Zharkut, Avdulla Hotit, Hikmete Bajramit për lidhjen e autostradës ne Gerlicë, vendim i datës 26.05.2017, nr. protokollit 256/17, e kjo u kane veç për fushatë, thjesht u kanë një maltretim i qytetareve që u ba, zgjerimi dhe asfaltimi i rrugëve është krejt prej vendimeve që naj ka pru 500.000 euro Sadovinë deri Sojevë për mu ky në autostradë kerkun hiq, as llaf nuk bahet, veç janë kanë për fushatë. Zgjerimi i rrugës Drobesh deri Mogillë, 150.000 euro i kushtum, hiq këto janë kane për fushatë. Skandaloze higjiena, krejt prej mjeteve të informimit, prej dokumenteve që kemi marr, kjo është puna e kryetarit. Kallxo.com, kriteret e kundërligjshme në punësimin në arsim të mësimdhënësve. Raporti i avokatit të popullit, shkelje të rëndë të punësimeve në Arsim. Drejtorët e shkollave, deri në një vjet me ushtrues detyre. Te shkolla ne Kabash p.sh. një vjet ushtrues detyre. Mbyllja e gjimnazit nga inspektoret e komunës sanitar dhe qohen me një vikend krejt punëtoret e komunës, me aktivistë me krejt me shpëtu, mos mu mbyll të Hënën. Qe ku i keni këtu raportet e këtyre, transparenca në

Komunë të Vitisë, nga instituti Gap, i publikuar në faqe zyrtare, ku e keni, ku Vitia renditet para Kllokotit, para Parteshit, para Ranillukit, para Deçanit edhe para disa komunave të vogla, është në nivelin ma të ulët. Punësimet në Arsim, edhe aty pa kriteret. Marrëveshjen e kryetarit me matrapazin në emër të GIZ-it për punë me nxënës nëpër shkollat e mesme, ku tri shkollat e mesme i ka mbledh nxënësit ma të mirë, 12 muaj është marr me ata nxënës, i ka plaçkitë, i ka marr i ka qu më së shumti në ekskursione, a në Prizren a në Brezovicë, që shkolla jonë kurrë nuk ka leju me qu nxanësat tonë në Brezovicë, ndërsa këta e kanë leju me marrëveshje që e keni bë, thjesht ka pas plaçkitje të nxënësve prej 25 deri 80 euro, nxanësat që i kanë dhënë këtij. Një rast në punësim, e qojnë në zëvendësim të lëndëve të matematikes në shkollën e teknikës, punon dy muaj, asnjë cent nuk ja japin, e shpallin konkursin, vjen tjetri, ai hec në shpi, asnjë cent nuk paguhet për ato dy muaj që ka punu. Te sporti, unë kam një shqetësim, ku kemi diskutu për fushën ndihmëse të ekipës së Pozheranit, ku fusha shkoj në Sadovinë, dhe tash ekipi i "Unitetit" është aktivizu, kjo ekipë do të fillon stërvitjet e do të fillon garat, aty do të ketë telashe që ajo fushë a do të përdoret për Unitetin. Te raporti financiar, që e kemi diskutu në seancën e kalume. Derivate, kryetari e ka një kerr 6799 euro, një veturë 6799 euro, nëse e llogarit që harxhon 10 litra n'qinë, përditë pune sa i ka dikun 4 ore e 20 minuta kerri ka hec i kryetarit në dite, përditë pune me naftën që e ka hargjit, mu ka dhimë shumë që 4 orë me nejt në kerr kryetari është diçka shume e ranë, ose i bjen 3133 orë gjatë ditëve të punës për një vit me naftën që e ka harxhit. Tani e pash, që 500 euro që ja ka ndërru ulën, mirë se e kishe rujt kerrin. 16139 dreka zyrtare edhe 1435 Zyra e Kryetarit dreka tjera, i bjen 17574 euro dreka zyrtare, 66 euro e 31 cent në ditë janë dreka zyrtare prej Zyrës së Kryetarit. Është shqetësuese. Sigurimin e automjetit 488 euro e ka pagu, 29 mijë euro kontrata mbi vepër, vetëm prej Zyrës së Kryetarit, 48 vet i ka qu ne shëndetësi vetëm për fushatë, ata as pagat nuk i kanë marr hala, si u kry fushata ata kanë hec në shpi, është gjynah, janë keqpërdor njerëzit.

z.Besim Ymeri: Përshëndetje të nderuar të pranishme! Po e citoj një thënie të një mikut tim. "Drita nuk ka kuptim nëse sytë janë të mbyllur". Prandaj, ju lus t'i hapeni sytë dhe t'i shikoni këto ndryshime që ndodhin. Më bëni përshtypje rekomandimet e rrezikshme që janë të barabarta me zero nga auditori është shume intereson dhe shume e arsyeshme që të flitet për problemet që ekzistojnë dhe që shihen në komunë, mirëpo me duket e paarsyeshme, se çdo gjë me vërejt me një ngjyrë te zezë. Bartja e mjeteve prej vitit 2017 në vitin 2018 tregon qartë, se buxheti në vitin 2017, edhe pse ka qenë zgjedhjet, nuk është përdor për fushatë elektorale apo siç u theksu me parë, por është përdor në mënyrën me të mirë të mundshme për realizimin e interesave të qytetarëve. Vet kjo tregon, se shfrytëzimi i këtyre mjeteve është nda në mënyrën me racional dhe me të arsyeshme.

z.Rasim Terziqi: Unë do të ndërlihem te tatimi në pronë. Është disproporcion i madh brenda një godine aty vjelën edhe tatimi në pronë po edhe taksa komunale 69% me 104% është një farë disbalansi i madh. D.m.th, mungesë e efikasitetit në punë te tatimi në pronë, ndërsa te taksat komunale, sikur që mi pru nja dy punëtorë prej Zvicres, që janë taman punëtor që punoj serioz, ku e kanë plotësu projektin. Edhe te ndarja e buxhetit, vazhdimisht keni kërku nga qeveria, që buxheti të ndahet në proporcion me banorët. Unë e shoh, që ndarja e buxhetit me banor në Komunën e Vitisë nuk është nda siç duhet, p.sh.: Pozharani ne nivel të komunës i ka nja 12 % të banorëve, e nëse shumëzohet kjo me 1 milion e 700 mijë euro të investimeve kapitale që i ndanë

Komuna, i bjen nja 200 mijë euro në vit. 4 vjet, kryetar, ka 200 mijë euro, 800 mijë euro. Unë 800 mijë euro investime në Pozharan nuk i shof, e shof nja 1.5 km rrugë, një park qe është investim ner 250 mijë euro, edhe ambulanta nëse është bë me mjete gjatë mandatit të juaj. Kryetar, unë kërkoj nga ju, që të bëhet një raport i investimeve sipas fshatrave, që të jen të precizume projektet dhe vlerat, d.m.th të nxjerrën statistika për çdo fshat. Gjatë mandatit të kaluar, Nexhmedin Arifi ka pas nxjerr këto statistika për çdo fshat, ku Pozharani ka pas dal fatkeqësisht nën investime të Beguncës, e kërkoj nga kryetari që t'i nxjerr këto statistikat e investimeve për çdo fshat.

z.Sejdi Emini: Përshëndetje për të gjithë! Unë do të replikoj me kolegun nga AKR-ja, më doket që dritat është tu i mbajt dhez edhe natën, bile natën shkymi, se edhe herën e kalue i ki krahasu qentë me njerëz, që nuk jam pajtu hiq, po sot mu imponu me dal, po të thamë, të lutem të jesh me i kujdesshëm. Pajtohem me Vjollcën për dallim prej Mirlindës që nuk u pajtu, ku Vjollca tha, “duhet me bë ndryshime afatgjatë që punët me qenë dikune se paku 20 vjeçare”, gjë për cilën duhet me qenë në fokus edhe ne si opozitë edhe ju si pozitë, por edhe qytetaret, se ato taksa janë të qytetarëve, ku punët të cilat kryhet duhet me qenë punë afatgjate, ku pajtohem me Beken që tha, “asfalti duhet me qenë 5 metra e jo 3 metra, jo 5 santi po 10 santi”, në të kryhen afatgjate e keni edhe përkrahjen tonë. Unë mendoj, që ato kompani që i kanë marr projektet e nuk i kane përfundu siç duhet, duhet me jav hup të drejtën e mos mi dhënë projekte herën e dytë. Nuk e kanë dëshmu veten dhe mos me leju prapë me vazhdu. U fol që ka qenë vit zgjedhor, po ka qen vit zgjedhor, fatmirësisht zgjedhjet kanë shku qysh kanë shku, jemi këtu ku jemi, kemi përgjegjësi para elektoratit ashtu qysh e kemi marr votën, mirëpo nuk ka qenë e mire dy dit parazgjedhjeve me i nda subvencionet, se ajo është drejtpërdrejt blerje e votës. Kështu që, të mësoni nga e kaluara. Unë mendoj, që punët të cilat kryhet duhet me qenë punë 20 vjeçare.

z.Besim Ymeri: Qentë endacak i han njerëzit, d.m.th jeta e njeriut është me e arsyeshme se sa dhuna në familje, për arsye se qeni e rrezikon direkt jetën e njeriut, ndërsa dhuna në familje ka shanca edhe me pshtu. Ndërsa thash, që sytë janë për me pa, e dilni shini projektet, thave që dritat i keni dhezur edhe natën. Unë nuk kame ni që dritat dhezen ditën, ndërsa për at që ju nuk po i hapeni sytë, duhet ti hapeni sytë dhe ta vreni ditën dhe dritën. Te puna e qenve endacak, janë në rrezik me se shumti fëmijët.

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje për KFOR-in amerikan dhe ju të pranishëm! Pasi u thanë shumë nga parafolësit vetëm të hyrat nga tatimi në pronë, pse në vitin 2017 janë me të vogla 167 mijë euro se ne vitin 2016. Asfaltimi i rrugëve rurale, 3200 mijë euro, d.m.th dyvjeçare, ku janë asfaltu në vitin 2017 këto rrugë rurale dhe cilat rrugë kane met mu asfaltu ne vitin 2018. Te kanalizimet janë 106 mije euro projekte dyvjeçare. Kryetar, kërkoj prej teje që një kanalizim të pumpa e Alidemëve, aty gjithmonë janë në rrugë ujërat e zeza. Ki bë punë nëpër katune tjera, po aty nuk u bë që 17 vjet mas luftës. Këtij koleges së AKR-së, po shifet që ki me përfitu diçka shumë frik, se ka njëherë njeri i ka dy sy, po njeri sy nuk shef hiq, po ty të kanë pa vetëm syri i keq, i miri nuk të ka pa hiq. Kryetar Sokol Haliti, urime mandati i dyte i kryetarit të komunës, po ta uroj publikisht, e ki fitu postin, e ki kalu të gjitha mundësi partiake që i ki pas postin e dytë e ki fitu si kryetar i qytetarëve të Komunës së Vitisë, d.m.th ki pas vota nga të gjithë partitë politike, por tani ti duhet të ja kthesh të gjithë qytetarëve njëjtë, e jo vetëm klaneve tua dhe shokëve tu. Kam një kërkesë,

tek Zyra e Prokurimit të kish më shume kujdes të punimet që bëhen. Investimet kapitale bëhen shume të dobëta. Unë e di që ti nuk mundesh me i kontrollu të gjitha ato, por përgjegjësia te qytetari vjen tek ti. Te punësimi, të kisha lut mos punëso njerëz që i kane të gjithë të punësuar, po punësohe naj njeri që e mban familjen. Të kish kujdes shumë më shumë te investimet kapitale dhe mbikëqyrja e tyre. Investimet kapitale që behet tu kisha lut të bëhen me perioda. Thave që e ki shfrytëzu buxhetin për investime kapitale në 99.99%. Kjo është rekord, as japonezët nuk e kishin shfrytëzu në këtë mënyrë, po keshyre afatin kohorë kur është shfrytëzu buxheti, keshyre, Nëntor-Dhjetor sa fatura kane ardh e sa i ki ne 10 muaj të tjera.

z.Besim Ymeri: Ekrem, nuk është në pyetje përfitimi personal, po është pyetje përfitimi i qytetarëve.

z.Ekrem Abazi: Po ju tham juve këshilltarëve, keni mu bind vet shumë frik, që ky e ka vetëm përfitimin e vet personal, se hala pa ardh në Kuvendin e parë ky ka keshyr me përfitu edhe kjo ka me ngja, e shihni vet dhe binduni.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kur është fjala këtë raport unë paraprakisht ka bë disa përgatitje po nj epjes e tyre u tha nga parafolësit, u ceken shume të arritura shumë punë që me disa prej të cilave edhe unë pajtohem, por me disa nuk mund të pajtohem. Janë bë disa punë, mirëpo nuk janë bë siç duhet mu bë, p.sh.: Te Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, nën pikën 4 thotë: “rregullimi i rrugës me zhavorr”, proces ekzekutimi dyvjeçar, shuma 67 mijë euro. Nga kjo shumë është investu edhe në fshatin Remnik në shtrirjen me zhavor të dy rrugëve fushore, dhe çfarë pune është be aty, çfarë cilësie e punës është bë aty, me të vërtet do të tmerroni po të ishit aty, dhe kryetar e kame pyetje drejtpërdrejt se a do të ndërmerri ndonjë punë shtesë, në ato rrugë për riparimin e tyre, se ato me sa e di unë në Shtator apo Tetor janë shtru dhe po dyshoj mos janë bë për fushat paraelektorale. Janë shumë të dëmtuara, po ndoshta fjalët thojnë i merr era po veprat mbesin, vepra është atje e dëshminë unë e kame këtu. Ja si duket rruga ne foto. Unë i kam marr në shumë pjesë, jo me than që vetëm me një pjesë, rrugët janë pa kanal anësor dhe nuk dijet a është rrugë apo është lum, dhe aty ku ka qenë pak uji me i shpejt aty edhe e ka marr, ja se si shifet si është i vendosur gypi për përcjelljen e ujit. Ky gyp as një të treten e ujit kur të bien shi të mëdha nuk e përcjell. Kjo është puna që është bë dhe nuk di që kushe nga komuna apo nga stafi i kryetari, që ka qen i detyruar ta përcjell atë pune, që ka dal ndonjëherë me pa, se çka është ka bëhet aty. Pastaj kemi te Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, përshkrimet jashtëzakonisht mbresëlënëse, po ne thellësi dalin në pah disa gjera, që nuk qëndrojnë. P.sh.: thuhet, se në Komunë tonë funksionojnë me katër qendra të mjekësisë familjare dhe gjashte ambulanca mjekësi familjare, për te tjerat nuk di. Të ju jap ndoshta ndonjë vlerësim, por për ambulancën e fshatin Remnik, mund të them se aty thuhet mjeku bënë vizita dy herë në javë, ndërsa tekniku çdo ditë është. Për teknikun mund të them nuk jam i sigurt, por mund të them se ka qenë i rregullt, ndërsa për mjekun nuk qëndron kjo. Pastaj ceket se jepen edhe kontrollet, ato çfarë janë bë në këtë ambulant dhe krejt në fund, atje jepen disa shifra me participim të pacienteve, ku thuhet në muajin dhjetor janë participu shtatë euro, nuk e di unë se kujt i janë participuar ato të holla, kështu që, ne muajin dhjetor ambulanca nuk ka funksionuar fare, sepse është në proces te rregullimit dhe të dislukimit në një vend tjetër. Te shkolla e mesme është bë rregullimi i kulmit të

shkollës, rreth 54 mijë euro kulmi. Me sa ma merr mendja mu, është be edhe aty pak a shume shkel e shko, fakt është po konkretisht mund të shkoni tani dhe para hyrjes se shkollës e keni tubin që rrjedh, d.m.th tubi përcjellës i ujit të kulmit rrjedh në shkallët e shkollës përball. Është marr edhe një aksion për rregullimin apo mirëmbajtjen e brendshme, një aksion tepër i shpejt. Nuk e di a ka qenë vullnetar apo çfarë, ku është bë sanimi i gjendjes, ngase që inspeksioni me dhënë urdhër që te mbyllet shkolla, ku para se te behet meremetimi i brendshëm, kemi qenë prezent në mandatin e kaluar në zyrën e drejtorit, i cili ka qenë ish-drejtori i shkollës ku unë kam qenë prezent, janë diskutu disa probleme, që janë për meremetimin, janë diskutu edhe dorezat e dyerve të klasave, të cilat sot e asaj dite nuk mbyllen. Dyert janë pa doreza ose te dëmtuara 90% e dorezave të dyerve. Këtë e ki than kryetar edhe ti vet ne takime, dhe e ki marr përsipër, që brenda afatit shumë të shkurt do ti rregullon, por nuk janë rregullu sot e asaj dite.

z.Samet Idrizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Te drejtoria e Bujqësisë dhe Drejtoria e Kulturës në Komunën e Vitisë, duhet gjithsesi me i dhanë përparësi Drejtorisë së Bujqërisë. Unë e shoh që këtu janë vlerat ekuivalente, pak a shumë te investimet dhe subvencioneve. Te Drejtorisë së Bujqësisë tu e pa, është shume e vërtet se ne Komunë të Vitisë investohet shumë në kulturë, rini e sport, është për me admiru, po karshi kapaciteteve që i kemi si Komune e vogël, unë mendoj që aktivitetet e kulturës, rinis, sportit po bëhen më shumë se në shumë komuna të mëdhaja. Andaj, edhe njëherë po e ceku, në të ardhmen kërkoj nga kryetari, që ne Drejtori të Bujqësisë të investohet më shumë se në at të Kulturës. Te Drejtoria e Inspeksionit, unë vazhdimisht e kam cek, se Drejtoria e Inspeksionit ka punë shumë në Viti dhe mundet me bë. Duhet me investu më shumë. Unë nuk e pash një raport shumë të detajuar këtu, me keqardhje e them, se ka ven më shumë me shqiptu gjoba për qytetarët e Komunës së Vitisë, edhe pse mundet me na kushtu me vota kjo, mirëpo ka do që hec në Komunën e Vitisë, ka një përmirësim te ambientit, mirëpo hudhet berlllog vend e pa vend. Për mu kjo është shumë jo e pëlqyeshme, edhe ka kërkoj që këtu te behet me shumë. Për Auditimin u fol nga kryetari, mirëpo në raportin e auditorit të jashtëm për vitin 2017 nuk e kemi marr ende, nuk i dimë rezultatet, ndoshta ti je i informuar, unë ju them zyrtarit të Auditimit të Brendshëm dhe zyrtarit të Prokurimit, nëse ndalim ne këndvështrimin profesional, e shiqojm Zyrën e Auditimi dhe Zyrën e Prokurimit janë dy zyrat më të rëndësishme, edhe se shumë drejtori, andaj edhe rezultatin se qyshe do të kemi raportin e auditorit të jashtëm varet shume nga auditori i brendshëm. Sa është serioz e profesional në pune e tij, te Zyra e Prokurimit duhet me respektu ligjin deri ne lidhje të kontratës, mbasi zyrtari i Prokurimit e nënshkruan kontratën, për ata që nuk e dinë nuk man përgjegjësi për realizimin e mirë apo të keq të projekteve. Sa janë të qëndrueshme investimet kapitale, apo shërbimet, furnizimet, kriteret apo kushtet për ndërtimin e një projekti, zyrtari i prokurimit i merr të gatshme nga njësia përkatëse që e kërkon me bë një shërbim apo një furnizim, mirëpo kontrollin sa i përket të qëndrueshmëria e projekteve te investimeve kapitale, pra puna. Kërkoj prej kryetarit të jetë ne nivel të detyrës, të komunikoj me organet mbikëqyrëse që caktohen për me mbikëqyr at projekt që behet. Kemi një varg të projekteve që janë zhvillu në vitin 2017, mirëpo sa ato janë të qëndrueshme. Te konkurset që po bëhen në Komunë të Vitisë për punësim, na e dimë që më së shumti ka konkurse në Drejtori të Arsimit. Janë raportu sa konkurse, por konkurset në Komunë nuk janë raportu. Te punësimet kryetar, siç e dimë na, ka dy ligje, një ligj

Nr.02/L-2 për Familjet e Dëshmorëve dhe ligji Nr.04/L261 për Veteranet luftëtarëve të UCK-së. Unë kërkoj, që këto ligje të respektohen. Sa i përket te punësimet të fëmijët e dëshmore edhe të fëmijët e luftëtarëve të UCK-së, unë e shfrytëzoj rastin me lexu para juve edhe një shkresë shpjegim që e ka bë ish-ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, bashkë me ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, me datën 22.02.2017, ku ja ka drejtu kryetarëve të Komunave të Republikës së Kosovës dhe kryesuesve të Kuvendeve, thotë: “të nderuar Ministri e Administratës se Pushteti Lokal dhe Ministri e Punës dhe Mirëqenies Sociale, duke u bazu ne Ligjin Nr.04/L261 për veteranet e luftës edhe për familjaret e dëshmorëve, në kushte të barabarta që ata të kenë prioritet në punësim, mu me ka interesu, kame pyet komuna tjera, këto të gjitha komunat e Kosovës e kanë hormonizu edhe unë kërkoj nga kryetari dhe nga drejtorit tjera përkatëse, që vërtet në kushte të barabarta, kur një femij i një dëshmori, i cili i vetfliju për këtë vend, mos te maltretohet po te merret në punë.

z.Taulant Haxhiu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Mu po me vjen mirë që sot kame rast të flas para kryetarit, është kryetari i vetëm gati ne Kosovë që ne seanca mungon me se shumti. Unë sot kërkoj prej z.Pira ,që te ma jep montazhin me te madh, unë do te flas për vitin 2018, për Shkollën “Dëshmorët e Vitisë”, t’i ja jap një raport kryetari, për shkak se drejtori veç tash jep dorëheqje, ku para 15 dite ka deklaruar që kam dhanë dorëheqje. Po kryetari deri tash hala nuk e ka bë publike. Qytetarët e Komunës së Vitisë nuk e din, por nënkryetari Hasan Alia e dinë, që në shkollën “Dëshmorët e Vitisë” ka qenë një bashkëpunëtor i imi. Unë e kame një kompani private, që ai me tha Taulan nuk muj me ardhë ne punë 10 ditë, tha se djali im Ismet Sylejmani, babi i këtij është Festim Sylja, Ismet Sylejmani ka qenë më herët një njëri që ka dhanë shumë për çështje kombëtare, është helmu ne shkollën “Dëshmorët e Vitisë”, është helmu nga ushqimi i cili përgatitet ne shkollë nga shoqata e grave. Lus kryetarin, që me nxansat e shkollës të ketë një vëmendje me te madhe, që mos të helmohen, se është fëmijë, mundet edhe te vdes. Unë e kame informu nënkryetarin, edhe qoftë se mendoni që është e pavërtetë, unë kame edhe dëshmi. Analizat e mjekut ku ai është helmu në shkollën “Dëshmorët e Vitisë”. Rruga Lubish-Viti, plasaritjet e asfaltit ne këtë rrugë, siç shihet në foto zotri Zharku, ish-ministri e ka ditë që ka me shku në zgjedhje të parakohshme dhe ju ka deshtë, që vetëm ta shtron asfaltin që ti bënë vota kryetarit siç i ka bë, më shumë i ka bë vota Zharkut se sa anëtarëve të degës të cilët i ka qit për deputet, ku ata në bazë të neglizhencës së kryetarit e kanë ndërru edhe subjektin politik. Pyetje tjetër për “Flakadanin e Karadakut”, është manifestimi me i madh i dëshmorit Nijazi Azemi “Komandat Mjekra”. Ky manifestim duhet të jetë me i madh, ta ketë rëndësinë e vet. Unë isha pjesëmarrës me gjithë asamblist të tjerë dhe ishte e zbehtë mungesa e qytetarëve. Nijazi Azemi dhe gjithë dëshmorët e Vitisë, kanë dhanë jetën për këtë vend, fal tyre unë jam në këtë seancë së bashku me ju. Kryetari e dinë, që mos të ishin kanë dëshmorët e të cilët i përdor vetëm në fushata politike dhe me vonë, pas zgjedhjeve vetëm ju thotë po kryhet, dhe asgjë nuk bënë, edhe konkurset i ndërron vetëm për premtime parazgjedhore. Kryetar, mos te ishin kanë këta dëshmor, nuk ishe ti këtu, ishe kanë Vest Piliqi, të cilin e ke njoft mirë, kështu që “Flakadanin e Karadakut”, a ka mundësi këshilli organizativ të merr një organizim me të mirë, që të ketë interesim të qytetarëve, pjesëmarrja e qytetarëve e bënë ma të mire “Flakadanit”, ku në hapje të “Flakadanit kanë qenë 60 vetë. Duhet të

ndryshohet, të bëhet diçka, më intereson që të ketë interesim të qytetarëve. Ora letrare ka zgjat gjashtë orë, pa paralajmërim, prej 11 deri ne ora 17:15. Kanë prit për ore letrare, këtu ka reagu edhe Ramadan Asllani, për shkak, se ne rrejtët sociale nuk i keni lajmëru, ku këta ka shtatë orë janë sill nëpër Viti, tu pritë për orë letrare. Të lutem, kur të vinë musafirt nga Maqedonia, nga Shqipëria, merrni pak emocionalit, jo vetëm te kalon ajo ditë, të jeni me efikas.

z.Rasim Terziqi: Rreth stadiumit “Ibrahim Kurteshi”. Kryetar, duhet të merren masa dhe rreth infrastrukturës sportive në përgjithësi në Viti, duhet të thamë që në Pozharan duhet të ndërtohet një palestër sportive. Vetëm të kemi parasysh çka ka ndodhë në Pozharan. Dhjet vitet e fundit është shu klubi i Volejbollin, anëtare e superligës për meshkuj, është shumë klubi i volejbollit për femra anëtare e superligës, sot është formuar klubi i gjimnastikës, Hazir Alidema e menaxhon, emrin e veprimtarit të madhe Halil Alidema, a veprimtarin e saj e ushtron ne Gjilan. Vazhdimisht ke premtu që ki me bë më shumë për klubet sportive, a realiteti është më ndryshe.

Kryetari z.Sokol Haliti: Unë ju falënderoj sinqerisht për interesim që keni treguar ju si këshilltar. Unë kam dëshirë që gjerat të jen të argumentuara dhe debati i shnosh, pasi që gjithmonë sjell frute. Mirlinda i pat disa pyetje dhe vërejtje, të cilat i morra, janë konstruktive, por edhe te çështja gjinore, mendoj që kemi punu bukur shumë ne. Unë nuk e kam përmend një pjesë të asaj, përkrahja e shoqatave të grave, rinisë, KVRL-së, që jemi e vetmja Komunë. Edhe sa i përket seancave dëgjimore për buxhet, jemi të parët në Kosovë, që katër vite kemi mbaj më shumë se Prishtina, Mitrovica etj dhe disa punë të mira që janë bë dikun, megjithatë janë shtru edhe asfalte të mira dikun edhe infrastruktura e mirë, kanalizim i mirë, diku është bë qendër e mjekësisë familjare e mire etj, etj. Nuk është mirë këshilltarët me ngri tema, ku unë muj me demantu. Kisha pas dëshirë prej provoje që kam, ju me ngrit tema që unë nuk muj mi demantu, pasi që kjo me ndihmon mu, se komuna nuk është private e inja, është mirë mu informua para se me ngrit një temë, p.sh.: të projektet dyvjeçare, ka projekte që tash vazhdoj, dhe zyrat e caktuara munden me ju informu dhe tjetra, që jam plotësisht dakort me juve për vërejtje që keni ngrit, parimore, që janë për zero tolerancë ne implementim, planifikim. Se te implementimi i paraprin qëllimi, te planifikimi, nëse planifikimi nuk është i drejtë, ne nuk mujmë me mbikëqyr edhe kryetari asnjë, nëse planifikimi behet 5 centimetra, po ju thamë, që nuk ka kryetar të komunave të Kosovës që bënë ore të punës me shumë shtat dite në jave. Në këto segmente ku ne kemi qalu me vite, jo vetëm gjatë mandatit tim kemi qalu me vite. U fol për duhanin, edhe unë jam për me e respektu ligjin për duhanin, po besoj që ne institucion jemi duke e respektu. U fol për gropat septike, edhe këto janë në projekt. Te Drejtoria e Shëndetësisë, për punëtorë me KARITAS, nuk është problemi i fushatës, mirëpo familjet kanë nevojë për një pagë dhe ne kemi nevoja për mantil bardhë, jemi dakordu që ata me i angazhu në procesin e shëndetësisë, me i shërby qytetarëve te shëndetësia primare. Marrëveshja mes Ministrinë së Shëndetësisë, Komunës dhe KARITAS-it e ka pas afatin gjashtëmujor, nuk e ka pas për zgjedhje dhe marrëveshje të tjera që i ka pas Komuna me KARITAS-in, ku i kam gjetë prej ish kryetarit dhe kam vazhdu, për mos mi largu punëtorët që edhe na kanë nevojit dhe marrëveshja tjetër që është bë mes Ministrisë, KARITAS-it dhe Komunës, vetëm duhet të sqarohen këto dhe jemi dakort, apsolut nuk ka pas ndamje që janë pranu në punë, ka pas edhe fëmijë dëshmori, ka pas edhe të partive të tjera, nëse cilësohen si parti

punëtore mantelbardhët, mjeku, punëtorët teknik nuk cilësohen me parti. Te cilësia e punëve, e ceku Bekimi, jam dakort Bekim, por a kemi përmirësim prej mandatit që kam ardhë unë, kemi, por a duhet këtë mandat me shku përpara, duhet me shku përpara, a duhet mi pri planifikimi implementimit të saktë, a duhet buxheti mu rrit për projekte, po, pajtohëm, kemi investime kapitale, qysh i kemi jam mundu me shpërnda buxhetin në të gjitha fshatrat, se u cek Pozharani nga këshilltari, unë po e demantoj, se kur ta merr për baze sheshin e Pozharanit, investimet në shkollën e Mesme Teknike Profesionale, investimet në Stadiume, parqet që kanë hi vitin e kaluar, kur ta merr për bazë ambulanten e QKMF-në, shkollën e Pozharani, përqindja e këtyre del më e madhe dhe rrugët, ndriçimet, rrugët bujqësore, del me e madhe se ajo që e ceki asamblisti del 100% me e madhe. E di sigurt, se unë me bashkëpunëtor çdo fshat e analizoj dhe shpërndarje, e bëjmë mirë. Projekti i shkollës në Pozharan, projekti i Stadiumit ka hi vjet, ani pse ka ankesa, operatori, ai ka hi vjet, Lidhja e autostradës në Gerlicë, vendimi është legjitim, që e konfirmoj edhe ministri i Infrastrukturës, që ke në zyrën time, në të njëjtën ditë që tha Taulanti, nuk jam kanë në Kuvend, po atë ditë unë e kam prit ministrin e Infrastrukturës dhe zëvendës ministrin Mujota në zyrën time, i kam pritë dhe i kame lut me ardh në Kuvend, e kemi pas debatin ma të nxehtë atë ditë për Gerlicë. Rruga Sadovinë e Jerlive - Dardani dhe rruga Drobesh Mugillë janë në procedurë, janë zgjedh edhe operatorët ekonomik dhe memorandumet, atë ditë është nënshkru në zyrën me ministrin e Infrastrukturës, janë të rregullta, është buxheti i zotum njëjtë siç fillon edhe për stadiumin e Pozharanit. Sa i përket lidhjes në autostradë, vendimi, edhe në konferencën e shtypit kemi thanë, së bashku me ministrin, se është ligjore, është legal, për shkak, se Qeveria e Kosovës, në përputhshmëri me ligjin, ka formu këshillin ndërministror prej 5 ministrave, prej tyre legalisht e kanë nënshkru 3 ministra, vendimi e kryqjes në Gerlicë dhe kërkesa im ka qenë mu implementu ky vendim. Buxheti nuk ju ka nda prej kësaj qeverie, në të cilën nuk jem ne. Unë kam kerku që kjo çështje urgjent mu nda buxheti dhe ministri e ka pohu, se vendimi është legjitim dhe do të shikojmë me implementu. U tha te ndarja e subvencioneve, subvencionet edhe sivjet janë me të njëjtin kalendar, ndarja e subvencioneve, munde të ketë zgjedhje edhe sivjet, mirëpo është me kalendar ndarja e subvencioneve, pavarësisht a mbahen a po jo zgjedhje. Ushtrues detyre në shkollën e Kabashit, po e kemi drejtorin e zgjedhur ushtrues detyre, ka shku në pension, për shkak se është emëru, se na ka vdek drejtoresha për fat të keq, ka qenë një drejtoresh e mirë, ka vdek e kemi emëru një ushtrues detyre konform ligjeve dhe tash është zgjedh drejtori i ri, ndërsa ushtruesi i detyrës ka shku në pension. Te Kuvendi i Lezhës, po ka qenë vullnetarizëm aksioni që e kemi marr, që e ka propozu kryetari i Komunës për një shkollë, ku kemi pas me së shumti nevojë, që vërtet nga aty kane dal shumë kuadro, gjenerata shume të mira profesionaliste, e ku kane profesor të mirë. Kur kame ardh unë kryetar, shkolla e mesme “Kuvendi i Lezhës” nuk ka pas fushe sportive, nuk ka pas tretuar, nuk ka pas plato, nuk ka pas parking, nuk ka pas asnjë dru të mbjellur, nuk ka pas ulëse, nuk i ka pas nyjet sanitare në rregull, nuk e ka pas këtë kulm. Ne mund të flasim për dobësi dhe jam për me fol për dobësitë, por ma së pari të shikojmë çka është punu dhe ku kemi dobësi. Unë jam befasu kur kam pa, që shkolla nuk ka pas banjo, jemi komuna e parë që e kemi fitu digjitalizimin me Ministrinë e Arsimit, bashkarish me fondacioni Luxembur. U cek kerri i kryetarit, është viti 5 që jam kryetar, asnjëherë nuk e kam marr kerrin jashtë orarit të punës, me

ligj e kame të lejuar me marr, ama unë e kam parim, që nuk e marr, ai kerr vetëm për takime të punës shfrytëzohet. Unë edhe gjatë vizitës zyrtare mundohem me kursy. Po ju tregoj dy shembuj, unë për gjashtë ditë kame shku me 3000 euro, a jam kthy me 2470 euro, kam shku me 1000 euro jam kthy me 920 euro me bilet, pse nuk kame bë harxhime, i kame kthy mjetet që janë kanë zyrtare. Kam shku ne Shqipëri, kam than jo nuk po marr mëditje se ishmi një numër i madh, të marrshmi krejt mëditje na kushtojke shumë, edhe kam thanë nuk po marrim mëditje hiq, mundeni me i verifiku këto. Unë edhe kafe paguaj prej gjepit tem, këtë po ja thamë për herë të parë. Te transparenca, instituti GAP, shikone Vitia në katër vitet te premtimet është e renditur e para. E ki edhe raportin e progresit, është e para, e ki raportin e auditorit gjeneral, jemi të partë. Tash e kemi raportin e auditorit, e vetmja komune pa asnjë rekomandim. Këto janë të vërteta. Te fusha e futbollit në Sadovinë të Jerlive, e keni planifikimin zhvillimore që nuk e kam bë unë, u bë 2010-2020, aty e kemi planifikimet e fushave të futbollit, na e kemi Vitinë, Pozharani, Sadovinen dhe Sllatinën, katër fusha ju kane funksionalizu, katër klube, në Sllatinë momentalisht e kemi problemin me prona, në Sadovinë nuk kemi pas problem me prone dhe faktikisht fusha ndihmese e cila ka kalu nga federata që është nënshkru edhe me Ministrinë e Kulturës, ne e kemi nënshkru, ajo do të kryhet, do të jetë ne shërbim të plote për klubet e Vitisë, “Vllaznisë”, “Unitetit” dhe klubeve të tjera. Ne do t’i bëjmë sivjet tri fusha sintetike, besoj që këtë vit i kryejmë. Te ambulantet, po ju tregoj, që kujdestari ka pas edhe dy herë në jave ka qenë doktori në Remnik, por tash Remniki ka marr iniciativa tjera, jam tu e përkrah këtë iniciativë për me ndreq ambulanten e re si ne Skifteraj e kemi shti në planifikim dhe ne gjysmën e punës e kemi marr obligimin me Remnikun, do ta krym. Në seancën e ardhshme ju keni me bë vendimin për ambulanten e re dhe ne fillojmë planifikim buxhetor. Sivjet do të ketë planifikime edhe në ambient për shkak se as shkollë as ambulant nuk do të ndreqet, as nuk do të rivalizohet pa u rregullu ambienti i jashtëm. Këtu jemi tu e plotësu një standard, Rrugët me zhavorr, është projekt dyvjeçar, kur të përfundon projekti atëherë e shikojmë a kanë ardh në nivel. U përmend edhe shkolla, rezat e dyerve, po shkolla ka menaxher, unë e di që shkollës i mungon shtëpiaku, jemi tu tentu edhe atje edhe ne ambient, edhe në shtëpiak që te kompletojmë me staf. Hajde Kuvendi le ta miraton një projekt, si e ka bë Fushë Kosova, ku ne masi kemi nevojë, e kemi QKMF-ne në Pozharan dhe i kemi njerëz të pa punë t’i punësojmë, që unë po e propozoj dhe hinë njerëzit me provoj, e kanë krye praktikën, janë tu punu, që janë dakord, po edhe fëmijët e dëshmorëve aty, hajde, Kuvendi e ka të drejtën, na ja propozojmë, kemi nevojë shumë për mantelbardh, mirëpo mujmë mi qu proceset edhe i qojmë bashkë. Flakadani i Karadakut, po e tham, është shndërru në rritje si manifestim jashtëzakonisht shumë, nëse e ki pa pramë, natën finale, ku nuk i ka zanë salla, ka ingjizime e sheh. Kushtet atmosferike sivjet kanë dallu prej vitit të kaluar, na ka shkakto që me hi brenda në sallë jo jashtë si e kemi mbaj vitet tjera, përndryshe organizativisht ka qenë mirë. Gara e recituesve është zhvillu, ora e madhe letrare, garat në futboll të vogël, garat në shah, në pingpong etj etj. Për kapacitetet e Vitisë, asnjë Komunë ne Kosovë këto manifestime që janë zhvillu këto tri katër vitit e fundit, nuk mundet me i bë, nëse kam harru najsen janë drejtoret këtu me plotësojnë.

z.Bekim Azizi: Kryetari tha do të demantojmë sinqerisht kisha pas qefin me të madhin mu demantu vetëm le te behet kyqja ne autostrad une sot krey qka fola fola me letra nuk nxerra diqka

une edhe ne parlament e ndegjova diskutimi ishte problematik se kishin anez bu me disa marrveshje mu be aneks shtes ish procedur krejt tjeter që ishte problem, të transparenca une e thash at që e kame nxjerr prej faqes se GAP-it shihene se ku renditni ju, të qeshtja e punësimit eshte e vërtet që per mjekun nuk keshyren me parti po eshte e vërtet që punësimi edhe atje edhe atje edhe çdo kun behet me parti është e vërtet që anëtarët e PDK-se nuk vin në ren mu pranë ne pune.

z.Remzi Salihu: Kryetar, për shkollën e dhavë shpjegimet, të falënderoj, por ta bëj me dije, se shkolla nuk ka sallë të edukatës fizike. Te ambulanta në Remnik, nuk e di a me të pyet ty si kryetar apo me pyet vetveten se ku po jetoj unë, sepse e di shumë mirë gjendje e ambulantes, e di shumë mirë që vitin e fundit mjeku a ka qenë naj herë apo nuk ka qenë. Këtë nuk po e thamë vetëm të thamë diçka, prandaj aty ku ka për tu thanë diçka thuhet, ndërsa aty ku nuk ka për të than nuk folët fare. Pyetja ishte për shtrimi e rrugëve, a do të interevenoni, përgjigje nuk morra fare dhe të ambulanta ishte një participim, mirëpo ai participim është në muajin dhjetor e ku ne këtë muj ambulanta ka qenë fare jo në dispozicion.

znj. Mirlinda Sadiku: Kryetari e përmendi, që duhet të përdoret gjuha e argumentuar, ma merr mendja që koleget e argumentuan mjaft, e kam argumentuar edhe unë katër vite në mandatin paraprak, megjithatë në një shoqëri pluraliste kur ekziston pluralizmi politik, nuk shihen gjitha gjerat me një sy, madje as në familje e leje me ne një Komunë. Unë fola me argumente të qarta. Kryetar, këtu kemi vjetarin e vitit 2016, d.m.th. punimet janë krye te ambulanta, po pse nuk po funksionalizohet, është dashtë mu kry në fund të vitit 2017. Po ashtu është mirë që ekziston opozita, sepse ka mundësi që disa informacione nuk i ki ose nuk t'i japin, po duhesh ta dish, që për mu është shqetësuese, që gjitha projektet nuk marrin leje mjedisore komunale, për mu është shqetësuese që ka mjaft shkelje të procedurave për ndërtim, nuk po e thotë Mirlinda, por e thojnë drejtoret e tu, Goshicë dhe Sadovinë nuk ka motër medicinale. Mësimi joformal për hir të vërtetës, 2013, për katër vjet su pagu kurrë, po ashtu fundi që është shume e rëndësishme, Njësia e Auditorit të Brendshëm në kuadër të Komunës i ka dhënë 25 rekomandime, vetëm 11 janë zbatu pjesërisht, i ki 4, prandaj ky është një element shumë shqetësues që nuk po e thotë Mirlinda, po po e thojnë njerëzit të cilët janë kompetent në fushat e tyre përkatëse.

z.Taulant Haxhiu: Kryetar, potencove që je taku me Pal Leken, po ti ki ardh pastaj në seance kur ka fillu debati je largu, po me 8 Mars që ke seanca e jashtëzakonshme, pse nuk erdhe ti at ditë, se paku neve nuk na respekton si opozitë, por ditën e gruas me ja uru këtu në foltore me ju than, ti atë ditë s'je kane me Palin, je kanë në zyrën tanë. E me këtë qe e thash për "Flakadanin", unë nuk e kam thane vet qe u kane e zbehtë po e këta e kam marr nga shumica e qytetareve, edhe një pjesë dërmuese të anëtarëve te partisë tane, të cilët kane qenë nën patronatin tënd. Ti nuk me dhavë përgjigje, unë thash në sa ora ka fillu ora letrare, dhe në sa ora u kanë e parapamë. Unë të pyeta ne sa ora, e ti mendove qe po du me ta ndërpre fjalën se ty, s'ka mundësi me ta ndërpre fjalën këtu, je i fuqishëm, e ki kryesuesin tanin edhe për këtë helmimin, ti nuk me përgjigje, se kjo ke me e rëndësishmja gjate fjalimit tem. A ka mundësi një përgjigje për këtë helmim dhe një sqarim për opinionin?

Kryesuesi i kuvendit z. Naim Pira: Faleminderit Taulant, por kryesuesi është i te gjithëve, po një duhesh me ditë, qe kryetari e ka te drejtën me marr fjalën kur të donë dhe natyrisht 27

këshilltarë debatojnë dhe 27 duhet me ju dhanë përgjigje, për këtë arsye vyen kohe ma shumë, se për ndryshe të respektoj.

z.Sejdi Emimi: U diskutua mjaft shumë për gjera të rëndësishme sot në Kuvend po unë mendoj që gjeja ma e rëndësishme e cila është ne interes të banoreve të Komunës tone është kyçja e autostradës në Gerlicë. E kemi ngrit edhe në mandatin e kaluar, e unë mendoj që si institucione është reagu pak vonë. Pikërisht për këtë kemi mbet edhe pa kyçje në autostradë. Pikërisht në këtë faltore kam kërku të bashkohemi, ta lami politikën anash. Është në interes të qytetareve, po jemi zorrë qorre, kurrë nuk kena me mund me përfitua as ekonomikisht. Janë ba disa foto, edhe kryetari disa takime i ka ba, edhe Salih Salihu atje ndonjëherë e ka ngrit zërin, mirëpo ne kemi mbet pa kyçje në autostradë. Neve po na intereson me pas kyçje kryetar. Kisha ba thirrje nga kjo foltore, për të gjithë kolegët, të gjithë qytetareve, nëse nuk arrihet kjo me format të cilat jemi, e ndërrojna formën, ju bajmë ftesë qytetarëve, dalmi atje protestojmë, bajmë presion të arrijmë qëllimin tonë bashkërisht. O merre ti si qeverisje komunale ose pe marrim na e përkrahim njeri tjetrin, e arrijmë qëllimin, se këto tjerat në raport me Komunën kanë mu kanë të parëndësishme në raport me kyçje, e cila është e domosdoshme për banorët edhe qytetarët tanë.

Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti: E para dhe e fundit ishin për autostradën. Po ju përgjigjem të dyve me lejen e juve, e për transparencën nuk kam ma shumë, se nuk ka qeveri si Komuna e Vitisë, nuk ka pas ma transparente se kjo që është, e duhet ma shume sigurisht pajtohem edhe unë jam në kërkim të saj, e bashkërisht e shikojmë se cili sektorë nuk është transparent, cila zyre, cila çështje a ka pas transparencën ma shumë. Ju shikoni veç konferencat e shtypit, e shikone planin e punës, shikone kalendarin, vlerësimin, kjo çështje është ma transparente. Dhe tjetra, u përmend edhe konkursi, unë për shkak të asaj e kam anulë konkursin e fundit, e ju s'pe vlerësoni që është anulë bash për ata, mos transparencës bash për qete shkak, e ne kesi raste tilla na duhet me reagu ligjërisht në përputhshmëri me Ligjin mbi Qeverisjen Lokale edhe kemi me reagu, se nuk e kemi marr këtë çështje me hile, po e kemi marr me kompetence të plotë me qu deri në fund. Salla e edukatës fizike, ne i kemi ndreq fushat sportive, nuk ke pas fushe sportive siç ka qenë në 81-tën, njëjtë ka qenë shkolla e mesme profesionale edhe “Kuvendi i Lezhës”, dhe e keni pa sa fusha i kemi ndreq. E kemi ndreq palestrën sportive shkollore atje, që kanë mujt me shfrytëzu të dy shkollat, se i kam thanë me ba marrëveshje bashkërisht drejtorët, me shfrytëzu kohë pas kohe, dhe tjetrën që po mendojmë me rivitalizu të shkolla e mesme e vjetër profesionale, që po mendojmë edhe për shkollën e mesme “Kuvendi i Lezhës”. E tjetra, palestra sportive është tu ba, edhe në Pozheran shkolla e re e do të bahet edhe palestra sportive shkollore, dhe këto janë hapa që janë ba gjigante, se sa fusha sportive janë ndreq në Komunën e Vitisë për tri vite edhe në vitin e kalum sa janë punu. Shtrimi i rrugës bujqësore, nuk keve i koncentrum, se tu përgjigja. Është projekt dyvjeçar, kur të përfundon kena me bisedu bashkë, e ki të drejtën e kemi me dal me shiku, me bisedu bashkë, e ka afatin dyvjeçar të projektit, e kane ba bazën e parë, kana me përfundu e kur të përfundon plani dinamik e shikojmë apo jetë keq najsen jashta planifikimit që e kam ba. Ambulanta në Skifteraj, ka qenë pjesë e përbashkët e bashkëfinancimit, pjesën tonë si Komunë kemi me kry me përpikëri. I di edhe tri segmente të vogla që kane mbet, të dyert e të dritaret e ato kane mu kry me përpikëri, e për ata unë jam garant që kryhet. Na aty ku të kemi shkelje janë ankesat e

procedurat, mundeni mi pa e mi paraqite e mu anku në organe, ne komision, ne lidhje me konkurset mu anku në Këshillin e Pavarur e mu anku. Por, ta keni një gjë të kuartë, unë ende me vendimet e Këshillit të Pavarur që i kam pagu dyfish rrogë nuk kam gjetë mandatit të më, e duhet me pranë që është punë me rregullaritet, a ne mandatet e kalim shikoni i keni ekonomistët, e shikoni sa keni pagu rrogë, dyfish, për shkak se janë largu pa proces, e kjo është e vërtetë. Mirëpo, argumentoni, merrni nesë ju interesojnë e mos i besoni kryetarit po merrni argumentet që ku janë edhe zyrtar, këtu është edhe avokati, këtu e është çështje që duhet me kshyrë. Nuk përjashtohet mundësia e një shkeljes, po unë i inkurajoj gjithë ata që bahet shkelje mu anku. Tjetër, nuk kam dëshirë me ngitë çështje su pranë asnjë i PDK-së. Nëse su pranë asnjë i PDK-së, atëherë del që i LDK-se ose i VV-së, jo nuk trajtohen aplikuesit ne konkurs të PDK-së, LDK-së, VV-së, AAK-së, ata janë profesionalistë që i plotësojnë kushtet ose jo, që plotësojnë përvojë punë, kriteret profesionale ose jo. Nuk trajtohen të tillë, e unë kam argumente plotë që nuk është qashtu edhe nuk trajtohen, e trajtimin e tillë nuk kemi me leju, po ju të gjithë duhet me na ndihmu mos me leju të gjithë bashkë edhe me fjalor nëse përdorni të PDK-së nuk po pranohen ne nuk e ndihmojmë, ne duhet mi ndihmu që profesionalisti mu pranë sipas kriterëve të konkursit edhe të ligjit. D.m.th. kjo duhet kështu. Te motra ne ambulanten e Goshices dhe ne Sadovine. Në Sadovinë ka motër, nuk është pa mungesë 100%, ka, se këtu ka këshilltar të Sadovines e për Goshice ne keni nevojë për teknik. Mantel të bardhë Vitia ka nevojë, se shikoni numrin për kokë banori, a buxhet skena të lejum që na lejon me marrë stafe. Rregulloren tash e këna, pas konkursin për 5 nuk na keni leju e ne duhet të shikojmë marrëveshjen që ne t'i absorbojmë dhe t'i shërbejmë qytetarëve. Do të shikojmë bashkërisht ne Kuvend, qeveria e kuvendi mund të vendosmi bashkë për këtë aspekt. Me 8 Mars që s'kam qenë ne Kuvend, unë kam pas angazhime, evenimente, e kam pas angazhime me interes për Komunën e Vitisë. Te takimi mas ministrit, unë kam ardh, po e keni parasysht, që unë nuk kam mundësi me qëndru si kryetar komune, për ata nënkryetari është i rregullt këtu. Se me Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, nënkryetari është i rregullt dhe qeveria komunale dhe unë nuk kam mundësi me qëndru e duhet me pas mirëkuptim, e unë kuvendin e respektoj 100% dhe detyrimet që i kam këtu, për shkak, se si institucion i cili duhet mu respektu është me ligj dhe ne në plotni edhe unë po them, që gjetë mandatit katërvjeçar sa kam qenë, asnjë kryetar ne Kosovë, shikoni me cilën dush, edhe të Gjilanit, nuk keni qenë ma shumë në Kuvend sa që kam qenë unë dhe kam me qenë atëherë kur kam kohë. Unë nuk mu me nejt në zyrë, e s'ka gjasa një minute me nejt, unë e mos me ardh, p.sh.: te puna ku zhvillohet për interes, e ky debat është për interes të qytetarëve të Vitisë. Ne skena nevojë me i ik debatit absolut hiq, ne kemi me zhvillu debat, por, debat të kulturum, rregullor dhe tek e fundit edhe ne dobi të qytetarëve e jo debat të kotë. E ne dobi të qytetarëve dalmi edhe me alternativa, me propozime, me vërejtje konkrete dhe shkojmë, nëse ka propozime, p.sh.: për ato çështje që ne i bajmë ndryshe, jemi të hapur në këtë vit, e keni përpara edhe mandatin, e ne jemi tu fol për vitin e kalim që e ka vlerësu dikush. Sido që të thoni, e ka vlerësu. E ky helmimi nëpër shkollë, unë nuk dashta, se mas pari është drejtori i Inspeksionit këtu, një helmim mund të ndodhë, por p.sh.: pse s'ka ndodhë të tjerët, se ajo kuzhinë funksionon për krejt e për ka ndodhe për një individ është përshkrimi i punës për inspektorin sanitar, që duhet me shiku, e trajtojmë, drejtori e qonë e shikon këtë rast, pse mos me trajtu. Ne në këtë kuptim duhet

mu përmirësu, nëse kemi raste të izolime ose naj rast qe ka ndodhë e jo veç këtu, por kudo nëpër lokalet e tona, në shëndetin e qytetarit e kemi obligim me ligj me mbrojt. Mbrojtja, kontrolli janë për mu forcë jo veç këtu, edhe te sfera veterinere, ju e keni pa çështjen e mishit, e unë jam për mu forcë kjo çështje, se është drejtori i Inspeksionit dhe si rast nuk deshta, se për shkak se besoj se nëse është ne duhet me trajtu me shiku. Inspektori sanitar mu thirre edhe me pa situatën veç a veç, ne jemi për rregullaritet, por mos harroni, një tjetër shoqatën e kemi përkrah, e nuk e kemi përkrah me helmu kerkan, por e kemi përkrah me ba punësim, shoqatave te grave, të cilët i respektojnë kriteret higjienosanitare te funksionimit të një shërbimi që e bëjnë aty për qytetarë dhe janë rregullat strikt. E kemi inspektorin sanitar edhe ai është i pavarur në këtë kuptim. Ki mujt këtë çështje me ngrit të inspektori sanitar drejtpërdrejt. Ora letrare ka fillu në ora 17:00, mirëpo gabimisht ka dal në ora 11 në agjendë, mirëpo në ora 17:00 ka fillu dhe është përmirësu, është rregullu dhe njeri që se ka kuptu ka qenë prej Ferizajt e ka keqkuptu, mirëpo nuk u bë nami i botes, sepse aktivitetet kanë qenë pasdite.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që përfunduar me piken e dytë, unë me dakordimin e juaj vazhdojmë me seancën pas një pauze të drekës prej një ore.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim-plotësimit të rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoba me Nr. 01-110/05-58 e datës: 02.02.2018

Drejtori z.Ibrahim Rama: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Është fjala për rregulloren për taksa ngarkesa dhe gjoba, që është miratu në seancën e kaluar nga ju të nderuar, por MAPL-ja ka gjet disa rekomandime përmes Ministrisë së Financave, ku ka ndryshu disa nene ne kuptimin teknik, kurse si përmbajtje e rregullores është mirë. Ju propozim rregulloren e keni pranuar me kohe, për pyetje sqarime jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z. Naim Pira: Hap debat për këtë pikë, pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim: Kush është që të miratohet kjo pikë? Konstatohet që me votat e të gjithë të pranishmëve u miratu edhe kjo pikë.

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2017 në vitin 2018

Drejtori z.Ibrahim Rama: Fjala është për një propozim vendim për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2017 të barten në vitin 2018. Pra, kjo është një rregull ligji, ku të hyrat që grumbullohen në muajin e fundit të vitit të kaluar, ku ato nuk mund të shpenzohen në bazë të buxhetit qysh janë të parapamë me buxhet, kështu që, ato të hyra na me ligj jemi të detyruar t'i bartim me një vendim të Kuvendit Komunal në buxhetin për vitin 2018. Pikërisht këto të hyra duhet të destinohen në ato pjesë të buxhetit që ka met i pa plotësuar nga të hyrat e vitit 2017. Propozim vendimin e keni pranuar, për pyetje dhe sqarime jam ne dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat për këtë pikë, pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim: Kush është që të miratohet kjo pikë? Konstatohet që me votat e të gjithë të pranishmëve u miratu edhe kjo pikë.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin e veprimit për transparencës në Komunën e Vitisë për vitin 2018

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Përshëndetje për te gjithë ju, me kohë e keni marr materialin, unë nuk do ta elaboroj këtu planin e veprimit, për shkak se s'kam nevojë t'ja lexoj, por jam obligativ të tregoj, se ky plan ka rrjedh nga strategjia të cilën e kemi. Përbërja e kalum, ata të cilët kanë pas rastin me qene këshilltar të Kuvendit Komunal, përbërja e kalume e ka aprovu e ka miratu një strategji të çështjes së transparencës, dhe në kuadër të saj, në aspektin ligjor jemi obligativ, që çdo vit të bëjmë edhe plan veprimit lidhur me implementimin e asaj strategjie. Konform të ligjeve edhe strategjisë të cilët është aprovu nga ana e Kuvendit Komunal, është hartu edhe plani i veprimit, të cilën e keni para jush e unë jam këtu t'i dëgjoj vërejtjet nëse ka dikush lidhur me këtë plan.

z.Mirlinda Sadiku: Në vitin 2017, instituti GAP i ka vlersu diku rreth 285 dokumente, ma saktë ka publiku rezultate e këtij vlerësimi me 28.12.2017, ku quhej indeksi për transparence buxhetore të Komunës. Vitia është renditur gogja poshtë, 47.5%. Këtu isha lidh ma shumë tek Zyra e Prokurimit. Nëse e shikojmë Web faqen zyrtare, edhe këtë të rejën, po ashtu edhe atë të vjetrën, d.m.th. shumë dokumente aty mungojnë, mjafton të ulesh e të besh kërkime gogja të gjata në krahasim p.sh. me Komunën e Prishtinës, Kamenicës po ashtu Drenasin, Deqanin, janë të gjitha procedurat e prokurimit janë të publikuara, tu fillu prej planit prokurimit, dhënies së tenderëve, anulimit tenderëve, përfituesi i tenderëve, ndërsa në Web faqen zyrtare të Komunës së Vitisë kjo gjë mungon. E kam verifiku në vazhdimësi, aktiviteti i fundit i prokurimit publik i cili është publiku, ka qene viti 2016. D.m.th. duhet të përmirësohet në këtë aspekt, sepse nëse na nevojitet një informatë në lidhje me një tender të caktuar që ka të bëjë me Komunën e Vitisë, duhet të publikohet edhe në Web faqen zyrtare të komunës.

z.Mustafë Mehmeti, zyrtar për informim: Përshëndetje për te gjithë të pranishmit! Faleminderit Mirlindë për pyetjen, mbetet të ju njoftoj, se sa i përket çështjes së Prokurimit Publik, është shqetësim i të gjithë komunave të Kosovës e jo vetëm e Zyrës së Informimit në Komunën e Vitisë. Është vendosur në mbledhjen e fundit që e kena pas zyrtarët e transparencës në Komunën e Vitisë me komunat të tjera, është vendosur, që çështjet e prokurimit publik të vendoset vetëm linku i KRPP-së, përndryshe që quhet e-prokurimi. Sa i përket planit të prokurimit për planin publik dhe raportet e prokurimit publik për vitin 2017 dhe vitin 2018 janë të publikuara.

z.Mirlinda Sadiku: deshta ta kontestoj me plotë arsye atë çka e tha Mustafa, jo me larg se sot na nevojitet një informatë në lidhje me një tender të caktuar, ne nuk mundem me gjet atë informatë pikërisht në web faqen zyrtare. Po ashtu hynem edhe në KRPP-në e nivelit qendror, kjo është informatë sot, na u ka dashtë neve informacion në lidhje me atë tender e nuk kemi mujt me gjete atë informacion të caktuar. Nuk du ta kontestoj, por megjithatë unë kam hulumtu, kam kshyrë edhe në web faqet tjera të komunave tjera, edhe shumë mire i kanë të renditura procedurat e tenderimit, kush ka fitu tender, pse u anuloi ai tender, janë shume ma transparente, e këtë e kërkoj edhe nga Komuna e Vitisë dhe ekzekutivit.

z.Liridona Bislimi: Përshëndetje për Nënkryetarin, Kolegë asamblistë, Drejtor, Mediat! Sa i përket këtij propozimi, është mirë të miratohet, sepse ky propozim i jep prezantimin e obligimeve dhe detyrimeve ligjore të pushtetit lokal për llogaridhënie, e synohet t'i jepet një pasqyrë gjendjes në kuptimin e zbatimit të obligimeve dhe detyrimeve të Komunës në fushën e transparencës. Pjesëmarrja qytetare, transparenca vendimmarrja dhe demokracia lokale janë proceset të ndërlydhura, si të tilla çalimi në njëra nga këto elemente nënkupton shpëputjen nga procesi. Për këtë arsye, nëse autoriteti lokal synon të zbatoj në realitet demokracinë lokale, ai duhet të kujdeset maksimalisht për arritjen e standardeve të transparencës, të siguroj pjesëmarrjen e qytetareve, të merr në konsideratë obligimin e qytetarëve gjatë vendimmarrjes dhe përsëri në fund të jetë transparent ndaj qytetareve mbi vendimet e marra. Në të njëjtën kohë, vendimmarrja transparente

ngushton hapësirën për vendimet e dyshimta të zyrtareve në Komunë, ne çështjet te menaxhimit te buxhetit, punës dhe aseteve publike. Ky propozim është mirë te aprovohet, por edhe pse po aprovohet ai ma herët nuk është se është përmbajtur edhe mirë. Më herët nga Zyra e Auditimit ne raportin e tij te vitit 2016 është gjetur parregullsi, sidomos sa i përket transparencës në financa, gjithashtu ka mungesë në transparencën e prokurimit të tenderëve te ndryshëm, në punësime, në projekte te punëve te ndryshme, gjithashtu edhe ne kategorinë e subvencioneve dhe transferove kemi vërejtje te shumta. Miratimi i këtij propozimi si dhe mbështetja e tij ndikon shumë pozitivisht, për shkak se qytetaret e Vitisë tash kane filluar te interesohen edhe te kërkojnë informacione rreth vendimeve komunale. Nëse behet transparenca ne mënyre te rregullt, ajo lidh bashkëpunimin ne mes administratoreve te komunës dhe te qytetareve.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka te tjerë për diskutim e qes në votim: Kush është që të miratohet kjo pikë? Konstatoj që me votat e të gjithë të pranishmëve u miratu edhe kjo pikë.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Komitetit për Barazi Gjinore

Kryesuesi z.Naim Pira: Është një komitet qe është jo obligativ, por është një lloj performace dhe ne një mënyre obligative, se me Ligjin mbi Barazinë Gjinore, tash po i kshyrin pak senet ma strikt. Ka qenë një kontribut i te gjithë juve, posaçërisht i gjinisë femërore. Unë e kam sjell para juve si propozim vendim dhe mbetet në vullnetin e juve qe t’i caktoni anëtarët e komitetit. Shkojnë katër anëtar nga kuvendi dhe një do të shkoj nga shoqëria civile. Kisha propozu, që gjitha subjektet politike ma te mëdhaja qe janë në Kuvend, te na japin nga një propozim. Nëse nuk ka diskutim, se unë po konsideroj se është çështje qe kemi marr vendim për formimin e komitetit, por për komitet po marrmi sot. Urdhëroni, a keni propozim” Ilir, te lutem shënoj emrat. Nga LDK-ja, Valbona Haziri; nga VV-ja, Liridona Bislmi; nga PDK-ja, Taulant Haxhiu; nga AAK-ja, Ekrem Abazi. E tash na mbete një nga shoqëria civile ta propozojnë një femër. Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit te ditës me këta emra qe i propozuan? Konstatoj që me votat e të gjithë të pranishmëve u miratu edhe kjo pikë.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e asamblistëve, të cilët do ta përfaqësojnë Komunën e Vitisë në Asociacionin e Komunave të Kosovës

Sugjerohet, që përpos kryetarit dhe kryesuesit edhe tri subjektet ma te mëdhaja ta kenë edhe nga një anëtar. Mbledhja do te mbahet me 3 Prill në Emerald. Janë takime qe 3-4 here ne vit takohen ma shume jo. Kërkoj nga subjektet politike te na japin tre emra për këtë asociacion te komunave. Nga LDK-ja, Zekrija Zuka; nga VV-ja, Nijazi Isaku; nga PDK-ja Taulant Haxhiu. Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit te ditës me këta emra qe i propozuan? Konstatoj që me votat e të gjithë të pranishmëve u miratu edhe kjo pikë.

Si pikë të tetë të rendit të ditës kemi:

8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të Vendimit Nr.01-410/03-52, të datës 01.02.2018, të Komitetit për Politik dhe Financa

Është një vendim te cilën ne e kemi marr ne seancën e parë te Kuvendit te Vitisë. Thash pak ma herët, se Ligji për Barazi Gjinore na ka qit pak punë. Unë i kam pas dy tri takime me MAPL-në, e këtij vendimi te cilën naj kane rikthy ata ne një formë, ata nuk pajtohen, jo që s’pajtohen qe nuk duhet me qene Ligji për Barazi Gjinore, por nuk pajtohen për faktin se vete KQZ-ja kane leju

qe lista zgjedhore te jene me 30% femra dhe tash është një diskrepancë mes një propozimi qe ka qenë ma herët dhe ne vendimi qe kane leju tash. Por, sidoqoftë, unë kam qenë i obligueshme ta rikthej edhe njëherë për shkak penalizimeve qe munden me qene, ta rikthej edhe ne Kuvend. Nuk po kërkoj emra, por po kërkoj kshtu një ndihmës nga ju, unë ju sugjeroj dhe ajo letë mbetet ne vullnetin e juaj, nëse ka vullnet dikush t'ja lëshoj vendin ndonjë te gjinisë femërore, unë e mirëpres dhe jam falënderues. Unë si të tillë do ta dorëzoj prapë ne Zyrën Ligjore të MAPL-së. E hapi diskutimin për këtë rend dite, po ju la afat nëse do me repliku dikush brenda jave le te naj sjellin emrin e nëse jo unë do ta dorëzoj si të tillë çfarë ka qenë vendimi qe e kena marr para një muaj e gjysme apo dy muajve. Kush është që të miratohet ky vendim për çfarë unë e propozova? Konstatoj që me votat e të gjithë të pranishmëve u miratu edhe kjo pikë.

Si pikë të nëntë të rendit të ditës kemi:

9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësim të Vendimit Nr.01-410/03-57, të datës 02.02.2018, të Komitetit për Komunitete

Për dallim nga Komiteti për Politikë dhe Financa, ky komitet ka qene pak ma fleksibil dhe kane qenë pak ma tolerant. Ata kane pranue qe te ndërrohen me pëlqimin e tyre. Unë kam diskutu me komitetit hashkali, ai ka qenë i disponimit që të ndërrohet me Hazire Gjela dhe David Lipovicin me Kada Palaj, edhe ai ka pranue qe te ndërrohet. Nëse ka dikush me diskutu diçka, unë po e hapi diskutimin. A jeni qe këta emra te ndërrohen me emrat e mëparshëm? Atëherë po e hedh ne votim. Konstatoj që me votat e të gjithë të pranishmëve u miratu edhe kjo pikë.

Si pikë të dhjetë të rendit të ditës kemi:

10. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Planin Zhvillimor Komunal

Drejtori z.Ajet Sallahu: Përshëndetje Kryesues, Nënkyetar, Drejtor, Këshilltar e te tjerë! Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit, me propozim te kryetarit te Komunës, Sokol Halitit, ka përpiluar këtë propozim vendim. Ky propozim vendim është mbështetur ne Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligji për Planifikimin Hapësinor 04/L-174, Udhëzimin administrativ Nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartim, zbatim dhe monitorim te planit zhvillimor komunal, si dhe ne Statutin e Komunës së Vitisë, neni 50, paragrafi 50.1, shkronja n. Duke pasur parasysh, se plani zhvillimor komunal ka bërë disa vite dhe se udhëzimi administrativ i cekur me larte 11/2015 na obligon qe te bëjmë hartimin e ri te planit zhvillimor komunal, jo vetëm ne Komunën e Vitisë, po te gjitha komunat e Kosovës, kërkoj nga ju këshilltar, që ta aprovoni propozim vendimin, që të ja hapim rrugën punës për hartimin e këtij plani zhvillimor komunal ne Viti.

Kryesuesi z. Naim Pira: Hap diskutimin rreth kësaj pike.

z.Sejdi Emini: Plani zhvillimor komunal është një dokument shume i rëndësishëm, i cili jep kahje dhe zhvillim edhe Komunës tone, si ne qytetin ashtu edhe ne fshatra, mirëpo, nuk duhet te jete vetëm një letër e qe mos te gjej zbatueshmerine asnjëherë ne terren. Fatkeqësisht deri me tani po thuajse vetëm ka qene letër, e zbatueshmëri s'ka gjet fare. Unë i kam disa pyetje konkrete për drejtorin. A ka raport mbi implementimin e planit zhvillimor komunal, a keni naj raport, se sa është zhvillu ky plane zhvillimor komunal? E dyta, politikat e juaja qeverisëse a janë te orientuara në dispozitat e planit zhvillimor komunal, kur dihet se nuk është bërë asgjë ne fushën e mbrojtjes se kufijve ndërtimor nëpër fshatra? Në gjitha fshatrat e Komunës tone ka ndërtime të egra e fare kujdes, tu i zanë tokat ma te mira me ndërtime, që në të ardhëm edhe me dashtë me i rujt s'kemi me mujt, se jeni tu i nxane para kohës. Po ashtu nuk është bërë asgjë ne trajtimin e ujarëve te zeza. Sa i përket planit zhvillimor komunal, nuk është bere asgjë rreth tokës bujqësore, mbrojtjes te

zonave trashëgimisë kulturore, projektet ne planin zhvillimor buxhetor asnjëherë nuk janë përmendur ne këto projekte. D.m.th, Këto çka janë punu nuk janë kanë ne harmoni me planin zhvillimor komunal. Tash është koha me ndryshu këtë ne mënyrë që te gjej zbatueshmeri dhe te jete konform kërkesave të qytetarëve. Në pjesën mbrapa kishës katolike, te rruga “Idriz Seferi”, kemi disa kërkesa të disa banorëve, që ata kërkojnë me bë ndërtime kolektive e që do të ishte ne interes edhe të komunës edhe të banorëve, sepse aty me planin e kaluar zhvillimorë komunal, nuk u lejohet, edhe ne jemi ka e ndryshojmë këtë plan, e gjithherë me gjet zbatueshmeri, jo vetëm ta bëjmë po te gjen zbatueshmeri.

z.Samet Idrizi: Unë mendova me thanë shumë, por i than nga Sejda dhe më pëlqej se qysh u qas në këtë dokument. Është shumë e vërtet, e kemi pas një plan zhvillimor komunal në mandatin e parë nëse nuk gaboj të PDK-së, në nenin 5, subjekt përgjegjës për hartim, d.m.th është për hartim të planit zhvillimor komunal, caktohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit. Sigurisht do të konsultohet ose do të bëhet një tenderim, për me naj kry këto pune naj kompani, duhet të kemi kujdes me hartimi e kritereve dhe kushtet se me çfarë kompanie punojmë për me bë këtë plan zhvillimor. Unë jam që të behet ky plan, por duhet të kemi shume kujdes se kur të behet ky plan dhe mos të jetë vetëm në letër, duhet të orientohemi që të ndërtohet në mënyrë vertikale jo horizontale, është shpërnda, vazhdohet të ndërtohet ne mënyrë të pakontrolluar nga qytetarët, me leje pa leje. Unë kam pa hartën ne planin zhvillimor komunal të para 7-8 vjete, ka pas plan mu hap shume rrugë në qytete të Vitisë, sidomos edhe mu orientu ndërtimi me plan, si p.sh.: në Gjilan, është shumë zona dhe është bë tash ne mandatin e fundit. Janë qel me siguri 15 rrugë të reja, aty ku ka pas nevojë ka ndërtu dora e shteti, ka bë shpronësime në mënyrë mu koncentru urbanimi e jo p.sh.: Komuna e Vitisë, tash ki ndërtime në Kllokot, ki Drobesh, nuk kemi kapacitet ashtu, andaj edhe njëherë po thamë, është mirë masi që te koka këtu nënkryetari, po edhe drejtori i Urbanizmi, ta marrin seriozisht këtë punë dhe të fillohet edhe me hapjen e rrugëve të reja edhe me koncentrim më të mirë ndërtimi, po edhe në fshatra si Pozharan e disa me të mëdhaja.

z.Bekim Azizi: Plani Zhvillimor Komunal është një obligim edhe ligjor, që duhet të behet, dhe përmes këtij plani përgatiten edhe hapat e zhvillimit, ndërtimit të komunës. Unë kisha pas një kërkesë. Unë mendoj, që ka qenë e udhës ma së pari të na jepet të behet një raport i shkruar, sa është përmbajtur ai plani zhvillimor, ku ka pas devijime plani zhvillimor, cilat janë mundësitë që janë ruajt apo nuk janë ruajt. Unë mendoj, që ka qenë në rend të parë me na ardh një raport i gjendjes, se sa ka muj mu ruajt plani zhvillimor i kaluar. Unë e di, që çdo plan që behet në të ardhëm duhet me qenë me i mirë se sa ai i kaluari. Është shume normale, plani që do të bëhet është një bazë që bazohet në planin e kaluar dhe shifen mundësitë që të shkohet në anët pozitive dhe shifen të metat që kane qenë të planit të kaluar dhe ato të evitohet, me mundësi që te tentohet zakonisht në lejimin e planit që do të vjen në ndërtime me të larta, që te ruhet se paku tokat pjellore dhe mundësitë të hapet çështja e zhvillimit ekonomik të vendit. E di që kjo do të orientohet përmes grupeve punuese, që do të kenë shume kujdes që të kyqen ekspert sa me shumë, sa të ka mundësi të përgatitet me ekspert të Komunës, me njerëz që punojnë në Komunë, që paguhen nga Komuna dhe sa me pak të merren ekspert të jashtëm, që të kushton sa me lirë ky plan. Unë kisha thanë edhe njëherë një raport është mirë me naj përgatit, me na njoftu sa ka mujt mu shfrytëzu, sa u deviju plani i kaluar.

znj.Mirlinda Sadiku: Plani Zhvillimor Komunal u aprovu me 28.10.2010. Ka qenë një plan zhvillimor, i cili e ka përfshi Komunën për 10 vite 2010-2020, mirëpo më intereson drejtor ta di, se është një procedurë kogjo e gjate, se tek pas 18 muajve ndoshta do të na vjen në Kuvend. A do ta keni parasysh strategjinë zhvillimore të fshatrave, të cilën e ka përpilur Zyra e Investimeve ne krye me Mentor Rexhepin? Sepse, barra dhe pesha e këtij plani zhvillimor komunal vërehet edhe ne vitet me tutje ne zhvillim të Komunës së Vitisë dhe fshatrave të saj, sepse e dimë shume mire,

në seancën e Janarit patëm për fushën e futbollit ne Pozharan, që u gjendem para dy situatave sfiduese. Tash kemi këtë plan zhvillimor, ta dërgoj ne Pozharan apo ta dërgojmë në Sadovinë. Megjithatë pesha dhe përgjegjësia është shumë e madhe, edhe neve si legjislativ, po ashtu edhe sektorve ta japin kontributin e tyre është shqetësues. Bekimi tha me dhanë një vlerësim për planin e mëhershëm, që ka qenë pjesë e atij përpilimi. Ka qen edhe kryetari i tanishëm i Komunës. Vet drejtori e ka cek, që ka pas shkelje të procedurave në ndërtim. Po ashtu, asnjë investim që po behet infrastrukturor nuk po merr leje mjedisore komunale. Krejt këto duhet të shihen dhe të merren parasysh, si dhe me intereson drejtor për kuriozitet, e kame kërku udhëzimin administrativ të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, a ekziston mundësia që te neni që jeni thirr për zbatim dhe monitorim të planit zhvillimor komunal të keni gabuar, sepse neni 11 që është cek këtu, përfshinë paraqitjen hartografike, ndërsa për çështjen për të cilën folëm, hartimi zbatimin e monitorimit e planit zhvillimor komunal, është neni 12, kapitullin 3. Dua ata di këtë çështje, sepse është dokument zyrtar dhe përgjegjësia bjen edhe në ju dhe tek ne.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje të pranishëm! Me ne fund e kemi para vete propozim vendimi për hartimin e planit zhvillimor komunal, që besoj që me një hartim të detajuar të këtij plani, do të jenë të kënaqur edhe qytetaret. Se me planin e kaluar zhvillimor hapësinorë komunal, qytetaret kanë pasur dhe kanë hasur në shumë vështirësi, sidomos sa i përket pajisjeve me vlerë të urbanizmi. Koha për hartim, afati 18 mujor është një kohe që na jep mundësinë ta bëjmë dhe ta hartojmë një plan detal zhvillimor, që do të hy ne shërbim të qytetarëve dhe do të jetë stimulim për investime në ndërtim e jo pengesë. I kemi të gjitha zonat kadastrale në nivel të Komunës, që do të përfshijnë. Duhet të ketë parasysh drejtorja, që tokat pjellore në një mënyrë t'i mbrojmë, mos t'i tkurrmi, se ne si Komunë po edhe si shtet, kryesish jemi të bazuar ne bujqësi. Prandaj, duhet të kemi kujdes shumë të madhe në planin që do ta hartojmë dhe do ta implementojmë në mandatin e ardhshëm 10-vjeçar, sepse gjate këtij 10-vjeqari ndryshimet do të jenë zero, se janë te parapara të hartuara dhe afati kohor i këtij plani zhvillimor është 10-vjeçar.

z.Taulan Haxhiu: Ne lidhje me propozim vendimin për hartimi e planit zhvillimor komunal. Sipas neni 2 të këtij propozimi, plani zhvillimor i Komunës do të përfshi plani për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për periudhën 10-vjeqare. Unë mendoj, që në këtë plan duhet të përfshihen profesionist nga Komuna e Vitisë, gjithashtu duhet të pasur kujdese ne këtë plan, sepse dijet që jemi ka jetojmë me një kaos total urban. Kjo pikë banë mu votu, sepse është vetëm propozim për autorizimin e Komunës për me bë Planin e zhvillimit komunal.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: U parashtruan shume çështje të cilat kërkojnë një përgjigje apo një raportim që u kërkuar nga Bekimi. Megjithatë, nëse e shtrojmë si çështje a është zbatu plani gjithherë, po flasim për planin e aprovuar ne 2010. Ju vet jeni ballafaqu me këtë plan, ku i tha edhe Mirlinda, që në bazë atij plani jem obligu me qu fushën e futbollit në Sadovinë apo zonën ekonomike ne Budrikë. Se të investimet që kërkohen plotësim i kriterëve edhe pa u zbatu dhe bazu ne planin zhvillimor komunal nuk du të vlerësoj a ka qenë i mirë apo i keq, për shkak, se për me vlerësu duhet me qenë i rangut të atyre që e kanë bë apo i rangut me te lart. A kemi pas telashe, kërkesa të cilat unë nuk po lidhem në aspektin individual që u përmenden, situatën që e kemi në Komunën e Vitisë është ne situatë kogjo e vështirë që me bë një implementim të tillë, për shkak, se konsideroj se qeky komision të cilin ne veç e kemi themelu, komisioni nga Zyra e Kryetarit është formu gjithëpërfshirës, janë njerëz me profesional dhe po insistojmë gjithherë që ta punojnë planin zhvillimor komunal, struktura e cila është në kuadër të komunës, jo kompaninë private, se kompanitë private nuk po e kshyrin mundësinë komunës. E tha edhe këshilltari Sameti, se Gjilani i ka ba. Me ju hi çështjeve të shpronësimit kërkon mjete shumë. Në këtë aspekt jam laik ne atë drejtim e nuk jam profesional e as arkitekt, ndoshta do ta kisha marr krejt priz tjetër, ndoshta një

ingjizim te gjendjes te cilën e kem dhe çka mujmë me ba ni plane qe i përputhet territorit të Komunës së Vitisë edhe kushteve tona, por edhe qe garanton zhvillim te mëtutjeshëm, edhe që nuk i nal kërkesat e qytetareve, po ne përputhje me atë plane hecin njerëzit edhe munden me ndërta ndërtesa te ndryshme dhe krejt ne konform te kësaj ne e kem ba ni komision, i cili është ne përbërjen e gjerë të stafit civil, krejt njerëz profesional. Janë mbajt nja pesë takime, të cilat kem ardh në përfundim, se në radh të parë duhet me u formu nëngrupet dhe me fillu me punu ata ne formën ma te mirë të mundshme. Është hapi i parë ligjor qe duhet te jete edhe një vendim nga ana e Kuvendit Komunal, që me të vërtetë ti qasemi kësaj çështje dhe po i hijmë hartimit te planit zhvillimor komunal. Na e kem planin zhvillimor komunal, ne duhet ta titullojmë plotësim ndryshimin, por ligji nuk po lejojka ashtu hartim po e quaj, d.m.th edhepse e ki, po ligjvënësi ka thanë organi ma i lartë, edhepse unë si jurist nuk pajtohem me ata. Po ka thanë ashtu e duhet mu pajtu e duhet mu adaptu ligjeve te cilëve i kem ne fuqi. Prandaj, kërkohet një leje qe ju te jepni e ne te fillojmë nga ajo te cilët po mendojmë te bëjmë përpjekje maksimale, që të bahet jo nga kompanitë e jashtme, në rast se arrijmë me disa plotësime, në rast se kem nevojë ai komision do te paraqet, p.sh.: gjatë punës së tyre ekipore, do te thotë, ne kem nevojë edhe për këto kuadra te cilët ne nuk i kem ne kuadër te komunës dhe te blejmë shërbime, por jo me kompani, me individ qe për sa munden me marr edhe me mujt me kry këtë pune sa ma mirë, me ankesa sa ma te pakta te qytetarëve, po me një funksionalitet të plotë të atij plani zhvillimor komunal, që mos të kem lloj pyetje te cilët me thane apo implementohet apo shkelet, por ta kemi një plan edhe implementohet edhe nuk shkilet.

Drejtori z.Ajet Sallahu: Ma shumë patëm disa konstatime, se sa pyetje. Është një raport mbi implementimin e PZHK-së. Drejtorja bane një analizë vjetore çdo vjet se sa është implementu plani zhvillimor komunal, por megjithatë nuk është në pyetje se a është implementu ky plane zhvillimor apo nuk është, është pyetje se a është udhëzimi i ri administrativ dhe duhet te bahet hartimi i ri i PZHK-së, hartim i ri jo me ndryshu, por me hartimin e ri, dhe pasi ta përfundojmë bazën e hartimit te PZHK-së, pas përfundimit, atëherë duhet me shku edhe hartë ozonale që është e re. Një sistem i planifikimit i ri për Kosovën, d.m.th pas kësaj rrjedh tjetra. Sa i përket gjitha këtyre brengave te juaja se me të vërtetë ka pas disa harmoni mes planit zhvillimor komunal dhe kërkesat e qytetareve për ndërtim. Aty kemi rast, sepse për një plan zhvillimor komunal na duhen se paku tre vendime, me kalu ne Kuvend. E ky sot qe është për hartimin e planit zhvillimor komunal, vjen vendimi i dytë për shpalljen e diskutimit publik apo shqyrtimit publik dhe vendimi i trete për miratim. E shqyrtimi publik ka me zgjatë një muaj e qe ky mu implementu e gjithë qytetaret mu kane te njoftum, edhe me dhanë vërejtjen edhe sugjerimet e tyre. Sa i përket nenit 11.22, udhëzimi administrativ, krejt ka te beje me planin zhvillimor komunal. Na jemi orientu ne nenin 11, për arsye se duhet te obligohet paraqitja hartografike e PZHK-së, për këtë arsye ne jemi orientu ne nenin 11, që mos me lanë pa harta, d.m.th. me shti si obligim hartografinë ne planin zhvillimor komunal edhe neni 12, e krejt nenet kanë të bëjnë me PZHK-në, se ata edhe për hartimin edhe për zbatimin edhe për kontrollin janë krejt ato qe ne udhëzim administrativ i përfshinë. Se plani zhvillimor komunal është një plan multisektorial, prandaj nuk mund me pas edhe shume nënkomisione tjera te aspekteve te ndryshme, e qe udhëzimi administrativ i parasheh nënte komisione tjera. Duhet patjetër mu angazhu, sepse vetëm Drejtorja e Urbanizmit nuk ka shancë me ba vet.

Kyesuesi z.Naim Pira: Atëherë, mua me mbetet ta qes ne votim për miratim. Kush është qe te miratohet kjo pike e rendit ditës, qe ti jap një udhë fillimit te punimit te përpilimit te planit? Konstatoj që me votat e të gjithë të pranishmëve u miratu edhe kjo pikë dhe si pikë e jashtë rendit te ditës e kemi pyetje dhe propozime te këshilltarëve komunal. Hapi diskutimin, nëse ka dikush

ndonjë pyetje, megjithëse në raportin apo informatën që na sjelli kryetari u diskutu shumë për pika të rendit ditës. Por, nëse ka dikush naj pyetje a sugjerim shtesë, fjala është për juve.

z.Samet Idrizi: Nuk kam naj pyetje që lidhet me çështje lokale, megjithëse ne jemi Komune e qeveri lokale, por veç dashta personalisht me mbështet fuqishëm mbi aksionin e Policisë së Kosovës, arrestimin që i beri ish zyrtarit të lartë të Serbisë që ka hy në territor të Kosovës pa leje.

Kryesuesi z.Naim Pira: Konsideroj se është obligim ligjor dhe shtetëror, që ata të cilët i shkelin rregullat dhe ligjin e Republikës së Kosovës dhe organet janë të obligueshme të marrin masa, dhe konsideroj se kanë qenë konform ligjit edhe kushtetutës së Republikës së Kosovës.

z.Xhilsime Qamili: Përshëndetje për të gjithë! Pyetja jem do të drejtohet Drejtorit të Arsimit. Si qëndron gjendja me psikolog nëpër shkolla tona, që deri me sot veç e kemi të ditur këtë gjendje? Por, pyetja ime është të naj informoj drejtorin, si do të veprohet në të ardhmen, pasi që ne si qytetar e shohim si nevojë dhe arsyeshmëri shumë të madhe që në Komunën tone, duke e llogaritur numrin e nxënësve në shkollat e komunës, duhet të jemi me se paku 10 psikolog të cilët do të ndihmojnë në testet për orientimin profesional ligjëratat psikoedukative për parandalimin e dukurive negative, që vërtetë do kenë ndikim pozitiv për shoqërinë e Komunës sonë.

z.Mirlinda Sadiki: Vet arsimit është lami në veti, i ki mbikëqyrje 800 e tepër punëtor, kështu që, është një lami shumë e gjanë. Pyetjen e parë e kam, drejtor në vitin e kaluar Komiteti për Politikë dhe Financa na u pate sjell një rregullore për mësimin jo formal. E dinë edhe kolegu Bekimi, që patë pas shumë vërejtje, por ma ajo rregullore nuk është kthyer në komitet, e sidomos në aspektin e prokurimit. Pyetja e dytë drejtor i Arsimit, është shkolla e mesme profesionale, e ka një parcel të tokës në pronësi të saj, nëse nuk gaboj sikur të tregu i gjelbër edhe çka ke ba për me funksionalizua ato, e pse jo edhe me përdor për të mirat e shkollës. Tash e dimë se kemi shumë nxansa në mungesë të pares nuk ju ofrohet ma transport. Kemi shumë raste që janë ndal prej shkolle. Në dëgjimin buxhetor nënkryetar të vitit 11.12.2015, në fshatin Budrikë ka me qenë dhe unë keni qenë edhe ju prezent është prezentu, që zona ekonomike do të investohet tanë planin trevjeçar 2016,2017,2018. Me sa e kam pa unë vetëm pak zalle është hedh aty dhe shtri dhe rregullu një pjesë po jo aq shumë pjese e infrastrukturës, kur e dimë që ajo zonë ekonomike është diku rreth 12 hektar a do të mrrihet të përfundohet brenda vitit 2018. Kam pyetje për drejtorin e Inspeksionit, po drejtorin s'qenka këtu. Të gjithë jemi të shqetësuar me lajmet e fundit, se nuk e dimë çka po konsumojmë, sidomos me këto skandale të mishit nuk besoj që edhe Vitisë është e kursyer, por është mirë që të na jepni raport, se a ka inspektu kohet të fundit lidhje me cilësinë e mishit, sepse jo rastësisht thuhet, se rastet e kancerit janë në rritje në Kosovë, diku rreth 1500 raste edhe mënyra se si ushqehemi ndikon shumë për shëndet.

z.Bekim Azizi: Kam një kërkesë për juve, që në seancën e ardhshme të jete pike e rendit të ditës edhe raporti i auditorit të brendshëm. Një raport që unë e kam pa personalisht që e ke prurë në komitet ma herët e që mendova se në raport të kryetarit do të jete edhe ma gjanë, mirëpo në raport të kryetarit pak ma ndryshe ke.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ne jemi mundu që të jem konform ligjeve, të cilat janë në fuqi dhe si obligativ ka qenë që vetëm në komitet të vihet ai. Unë një gjë të tillë do të kërkoj. Unë besoj që ai e ka gatishmërinë edhe vullnetin që të vje para këshilltarëve.

z.Liridona Bislmi: Me datën 06 Mars të këtij muaji, në fshatin Drobesh filluan punimet për vendosjen e ndriçimit publik. Në web faqen zyrtare të Komunës së Vitisë shkruan kështu: “sot, me financimin e Komunës së Vitisë, në fshatin Drobesh i Epërm kanë filluar punimet për vendosjen e ndriçimit publik. Me këtë rast, nënkryetari i Komunës, Hasan Aliu si dhe kryesuesi i Kuvendit Komunal, Naim Pira, kanë qenë të pranishëm në ato punime ku u priten nga disa banorë të këtij lokaliteti. Banoret para tyre treguan, se ky projekt është i dobishëm për sigurinë e tyre”, kështu u

tha ne lajmin nga Komuna e Vitisë. Por, në realitet, ne fund te punimeve disa banor ishin të gëzuar disa të habitur. Të gëzuar ishin ata qe banonin ne atë rrugë, ku ndriçimi ishte rikthyer, të zhgënjyer ishin ata banorë ne pjesën ku nuk kishte ndriçim fare, konkretisht rruga “Gursel e Bajram Sylejmani”, ku kane mbetur ma shume se 30 shtëpi pa ndriçim publik, si dhe ne pjesën hyrëse te fshatit, ku njëherë ka qenë rruge kryesore te fillimi i rrugës nuk e kane ndriçuar fare për 400 metra, ndërsa te habitur kane qene pjesa dërmuese e fshatit, ku te këta banore është bërë një ndriçim jo normal, d.m.th. jashtë parametrave infrastrukturore, dritat janë vendosur në drunj te pishave, aq të holla, sa qe besoj qe edhe një erë e lehtë mund t’i rrezoj ato. Në asnjë vend te pazhvilluar ne bote nuk ish ba një gjest i tillë, pasi qe edhe nga pamja ashtu edhe nga vendosja kjo nuk nënkupton një rregull cilësor rreth shërbimit te drejtë. Unë kërkoj prej organeve kompetente, që këta drunj përfundimisht të largohen ose te zëvendësohen me shtylla ashtu siç kërkohet ligjërisht. Ky projekt është bërë në fillim te këtij viti, e kjo dëshmon se asnjëherë nuk përfundojnë ashtu siç parashihen në kontratë. Kjo është edhe një dëshmi, që edhe gjatë qeverisjes se kaluar, faktikisht një fenomen i ngjashëm po përsëritet edhe ne këtë vit. Andaj, Komuna ne investimet e saj të tregohet ma transparente, ma llogaridhënese, se tash qysh po zhvillon programin e saj ma shume gjana improvizime se sa veprime te rregullta. Një gjë të tillë e kam sjellur edhe me argumente rreth pishës edhe drita e vendosur në ta.

z.Jakup Demiri: Përhëndetje për te gjithë! Unë e pata një pyetje për kryetarin Sokol Halitin, po ai s’koka këtu, po megjithatë unë këtë pyetje e bëra edhe seancën e kaluar, mirëpo nuk morra përgjigje. Pyetjen për kryetarin po e la për seancën tjetër.

Drejtori z.Qahil Sinani: Përhëndetje për të gjithë! Është e vërtet që arsimit është lënë pas dore, mirëpo jo nga Komuna, por nga qendra. Është e vërtet që kanë bë eksperimente në Arsim, edhe ende po bëjnë eksperimente, mirëpo fajet i kanë ata. Ne jemi direkt të lidhur me Ministrinë e Arsimit. Frik e kam bë këtë analizë, në vitin 2014 kanë qenë 11 mijë e 470 nxanësa, tash i kemi 9 mijë e 200 nxanësa, 2300 nxanësa më pak. Llogarit, se secili vite nga 500 nxanësa më pak, që do me thënë, secilin vit një shkollë po shkon, a pagesat bëhen në kokë të nxënësve, edhe atë 21.30 euro. Tash kur të merret pagesa e Ministrisë së Arsimit në koke të nxënësit, është e vërtet që numri i punëtorëve del më i madh, por nuk kem faj se paralelet janë klasët, e nxënësit pakohen, por nuk mbyllet një klasë. Në Debëllde me një nxënës e kemi klasën e nëntë, po unë sun i siguroj për një nxënës bartjen, se kushton me shumë, më mirë qata arsimtar që janë qaty. E kemi në Çifllak me 3 nxënësa, e në shume katune të tjera është ra shumë numri i nxënësve, e ti se ki qare pa pranë punëtor, se është vendi i lirë i punës, a pagesat bahen ne koke te nxënësit. Prandaj, këtu është ai dallimi, një diferencë shume e madhe në arsim. 2300 nxanësa nuk është pak, është për katër vite. Ishte pyetja te drejtorët, leni se është udhëzimi administrativ për zgjedhjen e drejtorave. Tri herë ke të drejtë, në konkursin e pare duhet tre me qenë të barabartë, t’i plotësojnë kushtet, nëse një nuk i plotëson anulohet ai konkurs, e s’mund me zgjedh atë qe i plotëson kushtet. Dytin dy e tretin një, që do të thotë për një drejtor mundet mu shpall katër muaj, pesë mundet me shku konkursi, se 45 dite është pas ditës se mbyllet se konkursit për me kry atë procedurë. Çështja e psikologëve. Është e vërtetë, se është e nevojshme edhe e domosdoshme që secila shkollë ka nevojë për psikolog, jo pedagog, pedagog janë vete arsimtarët, a psikolog po, se ka nevojë për ata nxënës. Është fol edhe në kuadër të Ministrisë së Arsimit, kanë mbet që neve Vitisë na takojnë 15 në kuadër te shkollave, por nuk e kanë marr hala këtë qëndrim mi liru këto vende te punës, se ma së pari duhet me ta qu prej atjeshit, që ti ke te drejtë mi marr 15, që të hynë 15 punëtor te ri, këtu është çështja e psikologeve, jo e nevojshme por e domosdoshme, se janë shumë, na krejt ne kuadër te Arsimit e kem vetëm një psikologe ne DKA.

z.Taulant Hxhiu: Përshëndetje! Vetëm një pyetje e pata për drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Radio Televizioni “Iliria” e ka pas kontratën që ta transmetoj live “Flakadanin e Karadakut”, pse nuk e ka transmetu live, nëse ka një sqarim me kallxu, pasi e ka kontratën u dashtë me transmetu live.

Drejtori z.Milot Lala: Përshëndetje për te gjithë! Rreth pyetjes se z.Haxhiut. Këtë pyetje duhet me ja drejtu Zyrës së Prokurimit, ajo është përgjegjëse për këta. Sa i përket promovimit të “Flakadanit Karadakut”, është transmetu edhe nga Televizioni “Plus”, nga “Iliria” kanë qenë prezent edhe RTK-ja.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Taulant, ka pas shumë drejtpërdrejt që e kanë transmetu, po ty ta paska kap qatë kanal edhe kem me kshyre edhe ne seancën e ardhshme, të jesh i bindur do ta kesh përgjigjen. Unë do të interesohem konkretisht, megjithatë e di që “Plus Televizioni” po, “Radio Pozherani” po, se kam pas rast me pa, se natën e parë s’kam qenë unë. Mirlinda pyeti, shkolla e mesme Profesionale ka do tokë të tregu i gjelbër. Unë në vend me jav ba juve, se pasna ditë që keni edhe sekretar edhe drejtor, edhe nuk interesohen për pronat e veta, e ti po naj banë neve, sa çudi. Ti ke sekretar të shkollës, merr rrogën e jeni gogja si kallabllak aty, e kam me kërku këta, e ndoshta të ftoj edhe ty. Për zone ekonomike të cilën e shtrove, thatë se ke qenë edhe ti, po kam qenë edhe unë, megjithatë është thanë në atë kohë, se do të përfundon në vitin 2018. Është investim i ministrisë, e ne duhet t’i përshtatmi me stinën. Ne frik e kem edhe një kontratë, një marrëveshje, të cilën e kemi nënshkru me ministrin e ri, një investim në shumë prej 2 milion eurosh, e mund të zgjatë deri në vitin 2020, e janë pare të cilët merren nga ministria e linjës dhe ne duhet t’i përshtatmi atyne. E raportin e auditimit të cilin e kërkoj Bekimi, Bekë, mos po del shumë qesharake raporti i kryetarit, i drejtorav të drejtorive, i zyrave të kryetarit ke sot, na raport te auditimit javën e ardhshme, auditorin e brendshëm e ke pas nja tri orë qetu, së bashku me neve e nuk është shumë problematike, por po me doket pe devalvojmë edhe punën e Kuvendit, se ne atë raport që ju ka drejtu Zyrës së Kryetarit, unë veç jav bi në Kuvend, nuk është problem, se ai s’ka çka ndryshon tjetër. Unë jam obligativ me i thirr zyrat e me i thanë, se këshilltari i PDK-së ka kërku. Liridona çështjen e ndriçimit publik. Në radhë të parë me vje mirë që është hi në Drobesh. Në radh të dytë, me vjen keq që ndoshta si ka përfshi krejt shpiat, e ne po kem telashe aty ku po investojmë e nuk është në pyetje veç Drobeshi, është edhe Tërpeza, se disa herë më ka thirr njani për një shtyllë, se paska mbete keq, e kur është pyetja veç një shtyllë e ana tjetër ka me shku në dritë kjo është një e mrrime, edhe 9 shtylla të kofshin s’koka problem se tjetrat kokan kry. Është me rendësi, që pjesa tjetër koka kry. Kam pas problem edhe ne Remnik vitin e kalum, aq sa ka pas pare edhe u investu edhe ne Remnik, po jo krejt, e menihere u qunë ata tjerët pse ka dera jem jo. Ajo që punohet është mirë që u punu, e për mua është shqetësuese ata që e thave në shtylle druni, që unë e evidentova e do ta shikoj aspektin profesional, a u kry mirë, se a kanë mbet edhe 10 shtëpi a 20, në rast se nuk i kem kry tash e nuk ka mundësi me qenë në kontratë, i kryejmë vitin e ardhshëm. Asnjë skemë lind për një ditë e as s’kem me vdekë për një ditë, e krejt punët nuk kryhen për një ditë, ajo kërkon në vazhdimësi. Jakupi u kursy për kryetarin, besoj që nuk është problem ajo punë. Taulant, do te kujdesem, e ke me marr përgjigjen pse, kam mu interesu edhe për kontratë a e kem me të, a u kanë obligative nga kontrata, ka pas obligim me transmetu drejtpërdrejt, e shohim se cila u kanë arsyeja. Faleminderit shumë!

Mbledhja përfundoi me punë në ora 15:00 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
